



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

KONTRATE

Referenca SH/Sherbime/2016/FZHR/SH82

E lidhur ndermjet:

“FONDIT SHQIPTAR TE ZHVILLIMIT”

dhe

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Dea Studio” shpk (35%)
dhe “InfraKonsult” shpk (65%)

Me objekt: “Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), Bashkia Durrës” sipas detajimit të mëposhtëm:

NR	OBJEKTI I PROJEKTIT
1	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Shkollës se Muzikes "Jan Kukuzeli" Durrës
2	Shetitorja bregdetare përgjatë plazhit tek "Shkëmbi i Kavajës si dhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) - "Shkëmbi i Kavajës
3	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve Durrës
4	Rindërtimi i shkollës "Jusuf Puka" Durrës
5	Itinerar i ri turistik në zonën historike të qytetit të Durrësit (amfiteatër - fari)
6	Porta e Jallisë - hamami

Date: 14.11.2016

KONTRATE

Titulli i Kontratës: Projektimi i punimeve per projektin **“Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Durres”**, sipas detajimit ne tabelen e meposhtme:

NR	OBJEKTI I PROJEKTIT
1	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Shkolles se Muzikes "Jan Kukuzeli" Durres
2	Shetitorja bregdetare pergjate plazhit tek "Shkemberi i Kavajes si dhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) - "Shkemberi i Kavajes
3	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Qendres Kulturore te Femijeve Durres
4	Rindertimi i shkolles "Jusuf Puka" Durres
5	Itinerar i ri turistik ne zonen historike te qytetit te Durresit (amfiteater - fari)
6	Porta e Jallise - hamami

Kjo Kontratë është lidhur më datë 14/11/2016, midis **Fondit Shqiptar të Zhvillimit**, me adr. Rr. “Sami Frasheri”, Nr. 10, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Benet Beçi, Drejtor Ekzekutiv, tani e tutje referuar si “Autoriteti Kontraktor”, dhe bashkimit të Operatoreve Ekonomike **“Dea Studio” shpk**, me adrese: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla 1, kati 3, Tiranë, dhe **“InfraKonsult” shpk**, tani e tutje i quajtur si “Kontraktori”.

Menjëhere pasi Autoriteti Kontraktor ka paraqitur një kërkesë për realizimin e shërbimeve, duke i'u referuar Marrëveshjes Kuadër të lidhur më datë 08.06.2016 për **“Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Durres”**.

Menjëhere pasi Kontraktori, me anë të ofertës se tij, më datë 08.06.2016 bie dakord të realizojë Shërbimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (bashkëngjitur)
- Kushtet e Veçanta të Kontratës (bashkëngjitur)
- Termat e Referencës (bashkëngjitur)
- Formularin e Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi (bashkëngjitur)
- Marrëveshja e bashkepunimit ndermjet “Dea Studio” shpk dhe “InfraKonsult” shpk
- Formulari i Njoftimit të Fituesit (bashkëngjitur)
- Formularin e Sigurimit të Kontratës (bashkëngjitur)
- Detyra e projektimit (bashkëngjitur)
- Propozimi teknik i operatorit ekonomik (sipas propozimit të dorëzuar në tender)

Të gjitha këto dokumenta të bashkëngjitur përbejnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **33.707.265 (tridhjetë e tre milion e shtateqind e shtate mijë e dyqind e gjashtedhjetë e pese) lekë pa tvsh ose 40.448.718 (dyzet milion e katerqind e dyzet e tete mije e shtateqind e tetembedhjetë) Lekë me TVSH**, objekt i rishikimeve në respektim të përcaktimeve të VKM nr. 354, date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim teritori, projektim, mbikëqyrje dhe kontrollim”, për realizimin e Shërbimeve;



Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi, ka paraqitur një Sigurim Kontrate qe mban daten 08.06.2016 në shumën prej: **4.525.000 Leke** në formën e garancisë së sigurimit perpara lidhjes se marreveshjes kuader. Kjo garanci është e vlefshme deri ne realizimin e plote te kontrates.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Shërbimet për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë. Projektet qe jane kerkuar te hartohen permbliidhen ne tabelen e meposhtme:

NR	OBJEKTI I PROJEKTIT	VLERA PA TVSH PARA ULJES 9,5%	VLERA PA TVSH PAS ULJES 9,5%
1	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Shkolles se Muzikes "Jan Kukuzeli" Durres	7.071.028	6.399.280
2	Shetitorja bregdetare pergjate plazhit tek "Shkemb i Kavajes si dhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) - "Shkemb i Kavajes	15.924.700	14.411.854
3	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Qendres Kulturore te Femijeve Durres	1.805.146	1.633.657
4	Rindertimi i shkolles "Jusuf Puka" Durres	5.424.423	4.909.103
5	Itinerar i ri turistik ne zonen historike te qytetit te Durresit (amfiteater - fari)	5.657.744	5.120.258
6	Porta e Jallise - hamami	1.362.556	1.233.113
	SHUMA E PLOTE PA TVSH	37.245.597	33.707.265

3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Shërbimet, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Kontratë, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim te papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara seciles nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 14/11/2016 palët bien dakort për nenshkrimin e kësaj Kontrate.

Për Kontraktuesin

"Dea Studio" shpk

 Ewin
Dea Studio
Bull. "Dëshmorët e Kombit" Kullat, Bregu i Kullat, 1 Kat, 3
10000 Shkëmbi i Kavajës, Durres
info@dea-studio.com, www.dea-studio.com

Për Kontraktuesin

"InfraKonsult" shpk

 Ledi Struga
InfraKonsult
Kryesqiptarëve të Tiranës
Tiranë - Albania

Për Autoritetin Kontraktor

Benet BECI

Drejtor Ekzekutiv





KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet e Konsulencës

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.



Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.



6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime

9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjansë përse përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat

10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor



- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

Neni 12 Vendndodhja

- 12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
- 12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 14 Çmimi i Kontratës

- 14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Afatet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.



[Handwritten signature]



- 15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 16.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përçindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 18 Forca Madhore

- 18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep urdhëra të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.



- 19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shumta e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22 Ndryshimi i Porosisë

- 22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.



Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim

- 23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
- 24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26 Nënkontrata

- 26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsye nëse e aprovon apo jo atë.
- 26.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejte të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të jape me nënsipermarrje.



26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

Neni 27 Transferimi i të Drejtave

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 28 Sigurimi i Kontrates

28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 29 Baza Ligjore

29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31 Përfaqësimi i Palëve

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.



32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33 Llogaritja e Afateve

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK). Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do të mbizoterojnë ato të Kushteve të veçanta të kontrates.

Neni 1 Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**.
- 1.2 Kontraktori është: **bashkimi i Operatoreve Ekonomike "Dea Studio" shpk dhe "InfraKonsult" shpk**.
- 1.3 Baza ligjore: Kodi Civil, Ligji për Prokurimin Publik, VKM nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim".

Neni 2 Objekti i kontratës

- 2.1 Objekti i kontrates eshte projektimi i punimeve per projektin «**Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Durres**», sipas detajimit ne tabelen e meposhtme:

NR	OBJEKTI I PROJEKTIT
1	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Shkolles se Muzikes "Jan Kukuzeli" Durres
2	Shetitorja bregdetare pergjate plazhit tek "Shkemi i Kavajes si dhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) - "Shkemi i Kavajes
3	Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Qendres Kulturore te Femijeve Durres
4	Rindertimi i shkolles "Jusuf Puka" Durres
5	Itinerar i ri turistik ne zonen historike te qytetit te Durresit (amfiteater - fari)
6	Porta e Jallise - hamami

Neni 3 Afati i Kryerjes se Sherbimit

- 3.1 Zbatimi i kontrates duhet te filloje menjehere pas nenshkrimit te kontrates dhe dorezimi i sherbimeve do te kryhet sipas grafikut te meposhtem:

NR	FAZA E SHERBIMIT	AFATI I DOREZIMIT
1	Analiza e detyrës së projektimit /përcaktimi i bazës së projektit dhe hartimi i projektidese paraprake	1 muaj nga data e lidhjes se kontrates
2	Hartimi i projekt-idee përfundimtare	3 muaj nga data e lidhjes se kontrates
3	Hartimi i projektit te zbatimit dhe preventivit përfundimtar	4 muaj nga data e lidhjes se kontrates

Ne afatet e mesiperme nuk eshte perfshire koha e nevojshme per shqyrtimin dhe miratimin e projekteve nga Autoriteti Kontraktor dhe Bashkia Durres.



Neni 4 Çmimi i Kontrates

- 4.1 Çmimi per kryerjen e sherbimit do te jete sipas ofertes se paraqitur nga Kontraktori ne sesionin e hapjes se ofertave, zhvilluar ne date 08.02.2016 dhe te pranuar nga Autoriteti Kontraktor, si zbritje ne perqindje ne masen **9,5%** nga vlera e sherbimit, e llogaritur me tarifen maksimale ligjore per ate sherbim.
- 4.2 Çmimi i kontrates, duke aplikuar perqindjen e zbritjes te percaktuar ne nenin 4.1, objekt i rishikimeve ne respektim te VKM nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim" eshte **33.707.265 (tridhjetë e tre milion e shtateqind e shtate mijë e dyqind e gjashtedhjetë e pese) lekë pa tvsh ose 40.448.718 (dyzet milion e katerqind e dyzet e tete mije e shtateqind e tetembedhjetë) Lekë me TVSH.**
- 4.3 Çmimi i kontrates per sherbimin e projektimit eshte perlllogaritur mbi vleren e te gjitha fazave I - VI.
- 4.4 Çmimi i kontrates do te rishikohet menjehere pas lidhjes dhe ne baze te vleres se kontrates se nenshkruar per kryerjen e puneve publike (punimeve) per te cilen eshte hartuar projekti, duke u reflektuar ne nje shtojce kontrate.
- 4.5 Çmimi perfundimtar i kontrates do te rillogaritet mbi koston e llogaritshme perfundimtare dhe reale te punimeve brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes ne dorezim te puneve publike (punimeve), duke u reflektuar ne nje shtojce kontrate.
- 4.6 Ne rastin e moskryerjes se puneve publike (punimeve) per te cilen eshte hartuar projekti, çmimi perfundimtar i kontrates do te rillogaritet mbi vleren e fazave te kryera te shërbimit I-VI (VKM nr. 354, date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim").
- 4.7 Ne çmimin e kontrates perfshihen te gjitha detyrimet fiskale.

Neni 5 Kushtet e Pageses

- 5.1 Pagesa do te kryhet pas miratimit te sherbimeve te dorezuara sipas grafikut te dorezimeve te percaktuar ne nenin 3.1 te Kushteve te Veçanta te Kontrates dhe do te perfshije te gjitha fazat e sherbimit paraardhese te kryera nga Kontraktori.
- 5.2 Pagesa per sherbimin e projektimit per secilin dorezim te sherbimeve do te behet sipas skedarit te meposhtem:
- 5.2.1 Vlerat perkatese, percaktuar ne vlere monetare ne tabelen e meposhtme, do te paguhen pas miratimit te dokumentacionit per secilen faze, brenda 15 diteve kalendarike nga data e marrjes se kerkeses me shkrim per kryerjen e pageses, shoqeruar me faturen perkatese:



	PROJEKTI 1	PROJEKTI 2	PROJEKTI 3	PROJEKTI 4	PROJEKTI 5	PROJEKTI 6
--	------------	------------	------------	------------	------------	------------



Analiza e detyrës së projektimit /përcaktimi i bazës së projektit dhe Projekt-ideja paraprake	588,119	1,798,633	167,651	444,716	591,520	127,795
Topografia, gjeologjia, Vleresimi I ndikimit ne mjedis, Projekt-ideja përfundimtare dhe Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	1,715,335	4,000,616	355,599	1,346,202	1,582,114	430,642
Projekti i zbatimit dhe Preventivi përfundimtar	2,176,042	4,289,048	620,310	1,645,453	1,410,547	304,742
PAGESA MAKSIMALE PAS RILLOGARITJES PER FUNDIMTARE	1,919,784	4,323,556	490,097	1,472,731	1,536,077	369,934

5.2.2 Diferenca e mbetur per tu paguar, rillogaritur siç percaktohet ne nenin 4.5, por jo me shume se **40.448.718 (dyzet milion e katerqind e dyzet e tete mije e shtateqind e tetembedhjete)** Leke me TVSH ne total, do te paguhet brenda 30 diteve nga data e marrjes se kerkeses me shkrim per kryerjen e pageses, shoqeruar me faturen perkatese.

5.3 Monedha e pageses do te jete Leke.

Neni 6 Sigurimi i Kontrates

- 6.1 Sigurimi i kontrates ne shumen prej 10% te ofertes me TVSH, eshte ofruar nga Kontraktori per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.
- 6.2 Zbritjet periodike te garancise se kontrates: Garancia e kontrates do te mbetet e pandryshueshme.
- 6.3 Afati i garancise do te jete deri ne zbatimin e plote te kontrates.

Neni 7 Ndjekja e ekzekutimit te kontrates

- 7.1 Person i autorizuar i Autoritetit Kontraktor per ndjekjen e ekzekutimit te kontrates, pergjegjes per koordinimin dhe pranimin e sherbimit, eshte Z. Ahmet Marku.

Neni 8 Zgjidhja e Mosmarveshjeve

- 8.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet te bejne çdo perpjekje te zgjidhin mosmarveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose ne lidhje me kete marrveshje, me negociata direkte.
- 8.2 Ne se palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarveshjes ose konfliktit, problemet do te konsiderohen me ane te zgjidhjes se marveshjeve sipas kontrates dhe procedurave juridike ne fuqi sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise. Gjykata kompetente do te jete Gjykata Administrative e Shkalles se Pare, Tirane.



TERMAT E REFERENCES

1. Pershkrim i pergjithshem i sherbimeve

1.1 Sherbimet perfshijne pergatitjen e projekteve te detajuara teknike dhe sigurimin e sherbimit te mbikqyrjes teknike per punimet e ndertimit, per investimet e Njesive te Qeverisjes Vendore qe do te bashke/financohen nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve, per vitet 2016-2017.

2. Pershkrim i shkurter i qellimit te projektit per lidhjen e marreveshjes kuader

2.1 Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR) eshte nje fond i vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit ne favor te Njesive te Qeverisjes Vendore (NjQV), per te ndihmuar ne permiresimin e infrastruktures lokale dhe rajonale. Projektet/objektet qe financohen nga ky fond seleksionohen mbi baza konkuruesmerie dhe perzgjidhen nga Komiteti i FZHR (KFZHR).

2.2 Ne kuader te ndihmes dhene NjQV-ve, KFZHR ka perfshire ne skemen e financimit per vitet 2016 - 2017, bashkefinancimin e pjesshem te sherbimeve te projektimit te projekteve, per ato objekte qe do te perzgjidhen nga KFZHR si prioritare per financim gjate vitit 2016. Per kete arsye, KFZHR ka vene ne dispozicion nje fond prej rreth 200,000,000 Leke (perfshire TVSH), per te financuar keto sherbime per vitin 2016 dhe rreth 100,000,000 Leke (perfshire TVSH) jane planifikuar per vitin 2017.

2.4 Objektiv i perhershem i KFZHR eshte realizimi i investimeve te FZHR me cilesi me te larte, kohe me te shkurter dhe rritje te eficenses me reduktimin e kostove proceduriale dhe administrative qe shoqerojne procesin e realizimit te investimeve. Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshem te projekteve qe mund te financohen nga ky fond, per te rritur eficencen dhe cilesine ne sigurimin e ketyre sherbimeve, KFZHR nepermjet Fondit Shqiptar te Zhvillimit (FSHZH), do hape tenderat per lidhjen e disa marreveshjeve kuader, secila me nje operator ekonomike, te cilet do te kualifikohen dhe vleresohen per te ofruar keto sherbime. Perkufizimi i marreveshjes kuader jepet ne ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Per Prokurimin Publik', neni 3, pika 8/1.

2.4 Autoritet Kontraktor ne keto marreveshje kuader do te jete FSHZH.

2.5 Ne baze te ketyre marreveshjeve, FSHZH do te lidhe kontrata sherbimesh me Operatorin Ekonomik fitues, per nje grup objektesh specifike, per nje vlere jo me te larte se vlere e fondit limit.

2.6 Per te rritur cilesine e projekteve dhe ndikimin e tyre ne zonat specifike, projektet e financuara nga ky fond do te ndahen ndermjet disa bashkive te perzgjedhura nepermjet nje procesi konkurues te hapur nga FSHZH. Ky projekt do te sherbeje si nje proces model per zbatimin e projekteve te ngjashme edhe ne bashkite e tjera. Fondi limit per bashkine Durres eshte 50,000,000 Leke (perfshire TVSH). Per secilen bashki do te lidhet nje marreveshje kuader e veçante.

2.7 Kontratat e bazuara ne nje marreveshje kuader do te lidhen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nepermjet zbatimit te kushteve te parashtruara ne kete marreveshje.



2.8 Paralelisht me zhvillimin e ketyre tenderi po ndiqet edhe procedura e seleksionit te investimeve per te cilat kerkohen sherbimet ne kete tender. Ne perfundim te ketij procesi, do te miratohet lista perfundimtare e objekteve, sherbimet per te cilat jane objekt i kesaj marreveshje kuader dhe do te bashke/financohen nga FZHR nepermjet FSHZH.

2.9 Ne rast se gjykohet e nevojshme, per sherbime shtese te se njejtës natyre me sherbimet objekt prokurimi, KFZHR parashikon se fondi mund te shtohet me 20% te vleres se kontratave te lidhura me operatoret ekonomike.

3. Objektivat e sherbimeve

3.1 Objektivat e sherbimeve jane:

- a. Ndermarrja e studimeve dhe analizave te nevojshme per te pajisur Autoritetin Kontraktor me dokumentacionin e nevojshem qe te prokuroje ne menyre te suksesshme dhe menaxhoje punimet e ndertimit. Kjo perfshin informacionin, vleresimet dhe dokumentacionin e nevojshem per objektet specifike, duke perfshire projekt-idete, projektet e detajuara teknike paraprake, projektet e detajuara teknike perfundimtare, planet e monitorimit dhe menaxhimit social dhe te mjedisit, raportet e vleresimit te ndikimit social dhe ne mjedis, planet e shpronësimit, kur jane te nevojshme;
- b. Keshillimi i Autoritetit Kontraktor mbi opsionet e ndryshme per te zgjidhur çështjet teknike, mjedisore dhe sociale qe mund te ngrihen gjate zbatimit te projektit te propozuar.

3.2 Per arrijten e ketyre objektiveve, Kontraktori do te ndermarre kryerjen e detyrave te meposhtme:

Pergatitja e Projekteve Teknike te Detajuara dhe dokumentave te tjere shoqerues per punimet e ndertimit

- a. Kontraktori do te kryeje sherbimet e projektimit teknik te detajuar ne perputhje me kerkesat e pergjithshme te dhena ne Aneksat 1 dhe 2 te Termave te References. Kontraktori do te pergatise dhe dorezoje Raporte te Projekteve Teknike te detajuara per sejcilin objekt. Kontraktori do te perditesoje kostot e paravleresuara, duke perfshire kostot per menaxhimin social dhe mjedisor.
- b. Kontraktori do të përgatisë një Raport Mjedisor dhe Social për secilin projekt, për të marrë lejen e nevojshme mjedisore (vleresimin paraprak të ndikimit në mjedis apo kategoritë A, B apo C të Lejes Mjedisore) për çdo projekt. Këto raporte do të kombinohen në raportet e veçantë VNMS, përfshirë ato te Menaxhimit Mjedisor dhe Social dhe planet e monitorimit për secilën prej kontratave të punës bazuar ne legjislacionin ne fuqi dhe sipas kerkesave te percaktuara ne Aneksin 6 te Termave te References.
- c. Ne rast se eshte e nevojshme, Kontraktori do të përgatisë planet e shpronësimit sipas kerkesave te percaktuar ne Aneksin 7 te Termave te References.

4. Pershkrim i objekteve per te cilat ofrohen sherbimet

4.1 FZHR financon kryesisht projekte lokale (megjithese nuk perjashtohen edhe ato rajonale) te propozuara nga NjQV per objekte brenda territorit te tyre administrativ. Operatoret duhet te



[Handwritten signature]



marrin ne konsiderate se sherbimet do te kerkohen kryesisht per objekte te natyrave te ndryshme, si: sheshe urbane, permiresime te tjera ne zona urbane, rruge urbane dhe rurale, godina etj.

4.2 Pergjithesisht, vlera mesatare e investimeve tipike te FZHR eshte rreth 50,000,000 Leke. Numri i sakte i sherbimeve do te percaktohet ne varesi te natyres se objekteve te perfshira ne listen perfundimtare te objekteve te seleksionuara per investim, shkalles se veshtiresise se realizimit te tyre, etj.

4.3 Per sherbimet e projektimit per objektet e natyrave me tipike te financuara nga FZHR, Autoritetet Kontraktore kane kerkesat e pergjithshme te paraqitura ne Anekset 1 dhe 3 te ketyre Termave te References, te cilat jane te zbatueshme per te gjitha projektimet e objekteve te ketyre llojeve. Ndersa kerkesat dhe specifikimet e veçanta per sejcilin objekt do te diskutohen mes paleve ne negociatat per lidhjen e kontrates respektive per ate objekt.

5. Afatet e marreveshjes kuader, kohezgjatja e kryerjes se sherbimeve

5.1 Marreveshja kuader do te lidhet per nje periudhe dy vjeçare dhe kontratat specifike qe do te lidhen ne baze te saj parashikohen te nenshkruhen gjate periudhes Prill - Dhjetor 2016.

5.2 Synim paresor i KFZHR eshte sigurimi ne kohe sa me te shpejte i projekteve teknike cilesore, zbatimi i te cilave do te financohet nga FZHR gjate periudhes 2016-2017. Parashikohet qe menjehere me dorezimin e projektit/ve teknik per nje objekt specifik ose grup objektesh, KFZHR do te marre vendim per alokimin e fondeve per hapjen e tenderit te punimeve per ate objekt apo grup objektesh. Ne varesi te kohes se dorezimit te projekteve, varet ngushtesisht edhe fillimi i investimeve te reja te financuara nga FZHR per vitin 2016.

5.3 Per kete arsye, Operatoret Ekonomike duhet te çmojne kete fakt ne pergatitjen e propozimit te tyre teknik. Operatoret duhet te tregojne ne propozimin teknik se kane fleksibilitetin dhe jane ne gjendje per te pranuar ndryshimet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, nese kjo do te jete e nevojshme. Rritja e efijences ne kohen e dorezimit te sherbimeve nuk duhet te cenoje ne asnje rast cilesine e tyre.

5.4 Afatet e dorezimit te sherbimeve te percaktuara ne Ankesin 8 te ketyre Termave te References duhet te konsiderohen si afate maksimale te lejuara per dorezimin e tyre.

5.5 Afatet per dorezimin e sherbimeve per sejcilin objekt do te negociohen ne kontraten specifike qe do te lidhet per ate objekt dhe do te bazohen edhe ne propozimin teknik te paraqitur nga Operatori Ekonomik, si pjese e metodologjise se tij.

6. Metodologjia e llogaritjes se çmimit te kontrates

6.1 Marreveshja kuader qe do te lidhet ndermjet Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik eshte nje marreveshje ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, perfshire edhe çmimin e sherbimeve te ofruara nga Operatori Ekonomik.

6.2 Si pjese e vleresimit te ofertes ekonomikesht me te favorshme, Operatoret Ekonomike duhet te paraqesin nje oferte financiare, e cila perfaqeson çmimin e dhene nga Operatori Ekonomik ne kete tender dhe eshte pjese e vleresimit perfundimtar te ofertes se tij.



6.3 Per llogaritjen e çmimit të ofertes se tyre, Operatorët Ekonomike duhet të kenë parasysh sa më poshte:

- a. VKM nr. 704, date 29.10.2014, "Per miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" dhe anekset perkates miratuar me VKM nr. 888, date 17.12.2014.
- b. Kjo VKM miraton tarifat maksimale dhe minimale ligjore, te detyrueshme per zbatim ne Shqiperi, per sherbimet e projektimit, mbikqyrjes dhe sherbimeve te tjera te lidhura me zbatimin e punimeve. Ne vijim çdo reference per 'tarifat' nenkupton keto tarifa te miratuara me VKM nr. 704, date 29.10.2014;
- c. Te gjitha sherbimet objekt prokurimi jane te perfshira ne sherbimet e listuara ne VKM nr. 704, date 29.10.2014, per te cilat jane te miratuara tarifat ligjore minimale dhe maksimale. Me specifikisht, sherbimet do te kryhen per objekte te perfshira sipas rastit ne njeren nga kategorite e meposhtme:
 - Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre,
 - Strukturat në ambientet e jashtme,
 - Vepra inxhinierike,
 - Strukturat e transportit dhe qarkullimit,
 - Projektimi i strukturave me aftësi mbajtëse,
 - Sistemet teknike.

Gjithashtu, per secilin projekt, mund te kerkohen sherbime shtese, si:

- Studimeve të ndikimit në mjedis,
 - Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele,
 - Shërbimet e rilevimit topografik.
- d. Vlera financiare prej 25,000,000 Leke me TVSH, perfaqeson vleren maksimale, te llogaritur me vlerat e tarifave maksimale per grupin perkates, per te gjitha llojet dhe sasine e sherbimeve qe do te kontraktohen, brenda Marreveshjes Kuader.
 - e. Çmimi i ofruar nga Operatorët Ekonomike duhet të jete nje zbritje ne perqindje mbi vleren e fondit limit. Kjo zbritje perfaqeson oferten financiare te dhene nga Operatori Ekonomik ne tender.
 - f. Ky çmim, zbritja ne perqindje, do te perdoret per percaktimin e çmimit te kontratave per nje sherbim specifik. Pra, çmimi i çdo kontrate, qe do te lidhet nen Marreveshjen Kuader, do te percaktohet duke zbritur nga vlera e sherbimit, e llogaritur me tarifen maksimale ligjore per ate sherbim, çmimin e dhene ne tender (llogaritur sipas perqindjes).
 - g. Gjithashtu, Operatorët Ekonomike duhet të marrin ne konsiderate qe ne baze te VKM nr. 704, date 29.10.2014, çmimi i ofruar (zbritja ne perqindje) duhet të jete ne perputhje me kerkesat e ketij vendimi.



- h. Meqenese, sherbimet ofrohen per tipologji te ndryshme objektesh, Operatoret Ekonomike do te japin oferta brenda vleres se lejuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 704, date 29.10.2014.
- i. Per kategorite e sherbimeve shtese, si:
- studimet e ndikimit ne mjedis,
 - sherbimet qe i takojne nentokes dhe punimeve ne themele, dhe
 - sherbimet e rilevimit topografik,
- do te perdoret e njejta metodologji e percaktimit te çmimit, duke perdorur tarifat ne fuqi ne kohen e llogaritjes se çmimit te kontrates specifike.
- j. Ne vleren e fondit limit eshte perfshire edhe nje fond rezerve prej 5% e vleres se tij, i cili mund te perdoret sipas nevojës.

6. Burimet (stafi dhe mjetet e punes) e Kontraktorit

6.1 Kontraktori eshte i lire ti alokoje burimet e tij siç ai çmon se permbush me mire kerkesat e sherbimeve. Megjithate Kontraktori duhet te mbaje parasysh kerkesat e meposhtme per stafin kryesore dhe mbeshtetes, te cilat do te merren parasysh ne vleresimin teknik te propozimit te tij.

6.2 CV-te e stafit kryesor te kerkuar me poshte duhet te perfshihen ne propozimet teknike dhe do te vleresohen ne perputhje me kriteret e percaktuara.

6.3 Eshte gjykuar nga Autoriteti Kontraktues se stafi mbeshtetes i meposhtem do te kerkohet te asistojë ne pergatitjen e projekteve, gjate zbatimit te kontrates. Kontraktori nuk kerkohet te dergoje CV per keto persona mbeshtetes se bashku me propozimin teknik. Megjithate, ne kohen kur Autoriteti Kontraktor gjykon se keta specialiste kerkohen, CV-te e personelit te propozuar duhet ti dergohen Autoritetit Kontraktues per aprovim, perpara se keta specialiste te punesohen per kete kontrate.

- a. Inxhinier Mekanik
- b. Inxhinier Mjedisi
- c. Inxhinier Gjeodet
- d. Inxhinier hidrogjeolog
- e. Projektues sinjalizimi rrugor

6.4 Kontraktori duhet te kete zyrat e tij dhe mjetet e tij te punes, perfshire transportin, sistemin e komunikimit, kompjutera, printera, plotera, etj. Gjithashtu, ai duhet te mbuloje edhe kostot e qendrimit dhe te tjera te stafit te tij, gjate kryerjes se sherbimeve jashte vendbanimit.

7. Dorezimet e raporteve dhe sherbimeve

7.1 Per secilen kontrate, Kontraktori do te dorezoje raportet, te ndara sipas fazave ne afatet e kerkuara ne Aneksin 8, te cilat sipas nevojës se Autoritetit Kontraktues mund te diskutohen ne negociatat per nje objekt konkret, ne varesi te rremdesise dhe shkalles se veshitresise se objektit konkret.

8. Ndhma nga Autoriteti Kontraktor



8.1 Te dhenat e meposhtme, ne rast se disponohen nga Autoriteti Kontraktor do ti jepen Kontraktorit sipas kerkeses:

- Dokumentacioni teknik, specifikimet teknike te meparshme etj, te perdorura per kontrata te puneve te meparshme. Megjithate, keto mund te duhet te rishikohen per te perfshire ndryshime te nevojshme; dhe
- Nje kopje e studimeve dhe informacionit te disponueshem per projektet e propozuara.



Anekse te Termave te References

Aneksi 1 - Kerkesat e pergjithshme per hartimin e projekteve teknike te detajuara te objekteve rruge, ura e vepra arti

Aneksi 3 - Kerkesat e pergjithshme per hartimin e projekteve teknike te detajuara te objekteve godinave

Aneksi 6 - Kerkesat per vleresimin e ndikimit në mjedis (VNM)

Aneksi 7 - Kerkesat per planet e shpronësimit

Aneksi 8 - Kerkesat per raportimet dhe dorezimet e shërbimeve



Kerkesat e Pergjithshme

per hartimin e projekteve teknike te detajuara te objekteve rruge, ura e vepra arti

1. Projekt-ideja

1.1 Në studimin e objektit Kontraktori duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante, por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nënvariate tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme ti paraqesë.

1.2 Gjatë kësaj faze Kontraktori duhet që të përfshijë dhe aktivitetet e mëposhtme:

- Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamëndshmërisë të bëra gjatë fazave më të hereshme
- Përditesimin e llogaritjeve dhe zevëndësimin e hamëndësimeve të bëra më parë
- Përgatitjen e metodologjisë së përgjithshme të ndërtimit
- Përgatitjen e grafikut paraprak të programit të punimeve
- Përgatitjen e vlerësimit paraprak të kostos
- Ndikimet ndaj mjedisit
- Konsultimin me publikun

1.3 Projekt-ideja duhet që të paraqesë në formë të përgjithshme zgjidhjet përfundimtare të varianteve të propozuara të projektit.

1.4 Kontraktori gjatë kësaj faze do të përgatisë dhe të paraqesë për miratim studimet që vijojnë:

1.4.1 Studimi Topografik - Për këtë qëllim do të kryhet një rilevim topografik (i relievit dhe kuotave të terrenit) i cili do të hartohet nga Kontraktori dhe duhet të jetë i firmosur dhe vulosur edhe nga specialisti topograf.

1.4.2 Studimi gjeologjik - Ky studim do të paraqesë rezultatet egzistuese të përfituara prej shpimeve apo mostrave të materialeve të nxjerra gjatë fazës së projekt-idesë duke marrë parasysh dhe studimet e bëra në projekte të mëparshme. Studimi gjeologjik duhet të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e dherave, veçanërisht rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet studimit të vendeve ku do të parashikohen vepra arti (tombino, tunele, ura, etj.). Studimi do të shoqërohet dhe me fotografi të cilat së bashku me hartat dhe shpimet e kryera do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në studimin gjeoteknik. Studimi do të ketë datë dhe të jetë i konfirmuar nga specialisti gjeoteknik apo grupi i projektimit gjeoteknik.

1.4.3 Studimi Hidrologjik - Në këtë studim duhen të vlerësohen kushtet hidrologjike nga do të kalojë rruga duke përfshirë dhe studimin e drenazhimit të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.



Në përfundim të këtij studimi do të pregatitet Raporti Hidrologjik i cili do të ketë datë dhe të jetë i firmosur nga specialisti hidrolog.

1.4.4 Studimi i projektimit të Shtresave Rrugore - Në këtë studim Kontraktori do të mbështetet në planin perspektiv të zhvillimit të zonës duke trajtuar projektimin e shtresave rrugore për çdo seksion rrugor. Ky studim do të shtrihet për një periudhë 20-vjeçare për materialet fleksibël ndërsa për ato rigjide do të shtrihet për një periudhë 40-vjeçare. Ky raport do të ketë datë dhe do të konfirmohet nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

1.4.5 Metodologjia e Ndërtimit - Kontraktori do të përshkruajë për këtë fazë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikpamja teknike, logjistike dhe programore në përputhje me elementët teknikë të projektit dhe rekomandimet e VNM. Këtu duhen theksuar rreziqet e veçanta në të cilat do të ndeshet kontraktori dhe menyrat se si do të perballohen ato prej tij. Ky raport do të ketë datë dhe të firmoset nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

1.4.6 Raporti i Shpronësimeve - Ky raport do të paraqesë një listë të mundëshme shpronësimesh për të gjithë variantet që propozohen së bashku dhe me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotesohen në lidhje me projektin.


1.4.7 Kërkesat për leje apo licënsa - Në këtë raport Kontraktori do të raportojë për lejet apo kërkesat që duhen marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

1.4.8 Raporti mbi konsultimin e publikut - Ky raport do të përmbledhë të gjitha propozimet e konsultimit me publikun, me aktorët tjerë të interesuar, me entet shtetërorë si Bordi i Kullimit, KESH, Ndërmarjet Ujësjellës Kanalizime, Telekom, Institutin e Monumenteve të Kulturës, institucionet apo organizmat arkeologjike, etj.

1.4.9 Vizatimet - Kontraktori duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Horografia në shkallën 1: 10 000, 1:5000, ose 1:2000. Në rastet kur zona e studimit është shumë e madhe duhet të pregatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme
- Planimetri e rrugës në shkallë 1:1000; 1:500; 1:200
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100
- Profilat tërthore SH 1: 200; 1:100
- Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50
- Harta e rievimit topografik SH 1;1000; 1:500; 1:200
- Harta hidrollogjike SH 1:5 000
- Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200
- Vizatime të mureve mbajtës apo pritës etj. SH 1: 50: 1:100

1.4.10 Volumet e punës dhe Preventivi - Kontraktori do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt. Volumet do të llogariten në bazë të



vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet mesatare të miratuara me VKM dhe ato që nuk gjenden në manuale të shoqerohen me analiza teknike.

1.4.11 Projekt-ideja në këtë fazë do të përmbillet me raportin teknik në të cilin përmbledhet i gjithë procesi i të menduarit që ka shërbyer si bazë e punës për hartimin e Projekt-idesë. Në të përfshihen planimetritë dhe informacine tjera të rëndësishme siç janë studime të vecanta, foto, etj. Raporti i Projekt-idesë mbasi firmoset dhe vuloset nga specialistët e firmës Kontraktore paraqiten tek Autoriteti Kontraktual, në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim.

2. Projekt – Zbatimi

2.1 Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktor, Kontraktori do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

2.2 Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

2.2.1 Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj të zbatimit të punimeve.

2.2.2 Në këtë fazë Kontraktori do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes së pikave fikse të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve. Të gjitha kuotat e rrugës do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni, në distance jo më të mëdha se 1,000m. Në çdo rast me fillimin e punimeve nga kontraktori fitues, Kontraktori do të jetë prezent për dorëzimin e këtyre pikave.

2.2.3 Studimi topografik për rrugët ekzistuese, duhet të përfshijë një zonë zgjerimi minimumi 15m nga të dy anet e aksit të rrugës, gjë që do të bëjë të mundur zgjerimin apo ndryshimin e aksit të rrugës gjatë projektimit. Ndërsa përse u përket kryqezimeve ekzistuese duhet të përfshijë një zonë zgjerimi minimumi 100m nga të dy anet e aksit të rrugës, që të lejojë përmirësimin e apo ngritjen në kuotë të kryqezimeve. Seksionet në profilet gjatësore përgjatë aksit të rrugës duhet të jenë çdo 25m. Në rastet e kthesave, intersektimeve me kanalet kullues, hyrje daljet si dhe pikat ku rruga ndryshon në kuotë vertikale, duhet të merren në distanca më të vogla. Prerjet terthore do të jenë në distance jo më të mëdha se 25m për të gjithë gjatësinë e rrugës të survejuar. Gjithashtu, profilet terthor duhet të përmbajnë dhe ndërtimet që kufizojnë rrugën në të dy anet e saj si dhe kuotat e tokës ekzistuese për një rezultat më të mirë të vëllimeve germim/mbushje.

2.2.4 Studimi duhet të përmbajë informacion për ujrat sipërfaqësore dhe nëntoksore dhe strukturat e drenazheve.

2.2.5 Për të kryer survejimin topografik, Kontraktori do të përdorë Total Station, GPS ose pajisje të ngjashme me të në teknike dhe procedurë, të cilat zhvillohen në kompjuter në bazë të



modelimit topografik te terrenit. Modelimi i terrenit duhet te permbaje te gjitha karakteristikat si ato natyrale ashtu dhe ato te bera nga dora e njeriut, infrastrukturen tokesore e nentokesore brenda zones se survejuar (te jene te perfshira godinat sipas tipit dhe numrit te kateve, strukturat dhe kanalet e kullimit dhe drenazhimit, linjat e instalimeve te ndryshme, etj.).

2.3 Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik dhe Investigimi te Materialeve

2.3.1 Kontraktori në pregatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të pregatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt ideose pranë Autoritetit Kontraktual.

2.3.2 Studimi gjeologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukurinë, aksin dhe thellësinë e rreshqitjes, këndin dhe një analize e saktë gjeomorfologjike të zonave rrëshqitëse, si me poshte:

- Per gjurmen e rruges: Pikat e investigimit duhet te jene per çdo ndryshim te madh te kushteve te shtresave apo pikave te defleksionit, ose per çdo 500 m interval, te dukshme nga njeri tjetra. Pika te tjera investigimi duhen te hapen atje ku ka ndryshime te medha te gjendjes se materialit, nqs kerkohen. Pikat e investigimit duhet te germohen derisa te dale formacion i pershatshem ose minimumi 2m nga kuota e nenshtreses se rruges. Testet e duhura, sipas standardeve, do te behen nepermjet mostrave te marra nga pikat investiguese, per te percaktuar materialet e pershtatshme per zgjerimin e bankinave ose si pjese e strukturave te shtresave te reja.
- Per urat: Pikat e investigimit duhet te germohen ne çdo mbeshtetese dhe çdo pile.
- Per punime te tjera ne kantier: Investigime te domosdoshme duhet te kryhen ne vendet e marrjes se materialit dhe te vleresohen sasite e mundshme te disponueshme ne nje distance minimale me vendodhjen e gjurmes se rruges. Investigimi duhet gjithashtu te perfshije marrjen dhe testimin e kampioneve te agregateve nga guroret ekzistuese ne zonen e projektit.

2.3.3 Raporti i Studimit Gjeoteknik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike të trajtuar dhe për secilin objekt të veprës duke përfshirë dhe materialet e ndërtimit.

2.3.4 Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- tekstin e raportit, parametrat gjeoteknike të projektimit
- materialin grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të veçante te shpimeve
- fotografi ilustrative
- konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit

2.4 Investigimet Hidrologjike dhe Hidraulike

2.4.1 Kontraktori duhet te beje nje studim me te dhena suplementare te vlefshme dhe te nevojshme mbi hartën topografike, kohezgjatjes se rreshjeve, statistikave te tyre, karakteristika te dheut, bimesise etj, ne menyre qe te kete akses ne zonen ujembledhese si dhe parametrat hidraulike per te gjitha strukturat dhe tombinot ekzistuese dhe te reja qe do te parashikohen ne projekt.



2.4.2 Kontraktori do të mbledhë informacion mbi nivelet e permbytjes, kuoten e ulet të ujërave, shpejtesinë e shkarkimit etj, nga të dhëna të mëparshme të disponueshme, nga raporte investigimi ekzistues dhe shenja të dukshme në terren. Kontraktori do të vendosë në profil gjatësor apo tërthor brenda kufijve të fshatit/qytetit dhe të zonave të tjera përreth rrjetet ekzistuese, të cilat mund të integrohen në tombinot apo strukturat e rrugës. Kontraktori gjithashtu duhet të marrë parasysh survejimin e detajuar të kuotave të rrugës në intersektime për të siguruar kullimin e të gjithë zonës.

2.4.3 Kontraktori duhet të hartojë një inventar dhe të inspektojë gjendjen e të gjitha strukturave (tombino e ura etj) në përputhje me legjislacionin dhe standardin shqiptar. Kontraktori duhet të paraqesë në formë tabelore të gjitha të dhënat fizike e hidraulike të mbledhura.

2.5 Investigimet e Shtresave

2.5.1 Investigimet e shtresave të përshkruara në një mënyrë të tillë siç jepet në draftin e Manualit të Projektimit të Rrugeve për Shqipërinë ARDM3 dhe/ose ndonjë tjetër manual të përshtatshëm rrugësh, duhet të përfshijë vlerësimin e përberësve të shtresave dhe fortësive të strukturave, survejimin e gjendjes së shtresave si dhe përcaktimin e ashpërsisë së shtresës në përputhje me Sek 3.9 të ARDM3 dhe/ose ndonjë tjetër manual të përshtatshëm rrugësh.

2.5.2 Kontraktori, duhet të gërmojë në piketa testimi të përzgjedhura, për të qartësuar përberjen e shtresës. Investigime të detajuara në terren duhet të mbahen në mënyrë që të mblidhen të dhëna mbi gjendjen e rrugës dhe sipërfaqes së shtresës.

2.5.3 Duhet të bëhen gjithashtu investigime mbi ashpërsinë e shtresës, duke përdorur pajisje si Bump Integrator ose instrument të ngjashëm, mbi rrugët ku të dhënat mbi investigime nuk janë mbledhur ende. Investigimet duhet të mbahen përgjatë gjurmës si dhe duhet të mbulojë një minimum një distancë prej dy goditje përgjatë gjurmës së rrotës për çdo drejtim.

2.5.4 Kontraktori duhet të kryejë investigime të fortësive të strukturave për shtresat ekzistuese duke përdorur tekniken Benkelman Beam Deflection, ose një metodë tjetër të ngjashme. Testi i deflektimit duhet të kryhet në çdo 100 m interval në mënyrë të alternuar.

2.6 Investigimi i Shërbimeve Publike

2.6.1 Kontraktori duhet të mbledhë detaje të çdo parametri fizik përgjatë gjurmës së rrugës, duke përfshirë ndërtesat dhe strukturat, monumentet, varrezat, vendet religjioze (shenjta), linjat e hekurudhës, linjat e shtyllat elektrike e të telefonisë, shërbimet nëntokesore, vendodhjet e pusëtave, si dhe tipe të tjera shërbimesh si p.sh: fibra optike, pusëta të shiut, ujërave të zeza, tubacione të gazit/naftës në mënyrë të duhur dhe që pritet të preken nga ndërtimi i rrugës.

2.6.2 Informacioni i mbledhur duhet të paraqitet në një plan zhvendosjesh në mënyrë që zgjatja e afatit të dorëzimit dhe rivendosja e strukturave dhe shërbimeve të mund të vlerësohen në mënyrë të përshtatshme. Plane zhvendosjeje të ndara për çdo shërbim (energji, telefon, ujë etj.) të përfshirë, duhet të përgatiten për të lehtësuar kështu koordinimin me agjensitë në ngarkim.

2.7 Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit



2.7.1 Mbas përpunimit të projektit dhe hartimin e projektit përfundimtar të zbatimit Kontraktori duhet të kryejë rishikimin e metodollgjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet ti referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje kontraktori.

2.7.2 Këtu Kontraktori do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes së materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre.

2.7.3 Në këtë fazë gjithashtu, Kontraktori do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të spostimeve të ndryshme elektrofonike apo të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.

2.7.4 Kontraktori do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra gjatë zbatimit të punimeve për sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën.

2.8 Raporti përfundimtar i shpronësimeve

2.8.1 Kontraktori në këtë fazë do të rishikojë investigimet e kryera në fazën e projekt-idesë duke përshkruar tashmë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen sipërfaqet e objekteve apo trojeve të bashkëngjitura me planimetritë e objekteve dhe gen-planet e trojeve, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit.

2.8.2 Bashkëngjitur me këto të dhëna do të jenë dhe miratimet e Zyrave të rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo në mungesë të dokumenteve të pronësisë ato të ALUIZNIT apo çdo miratim tjetër nga Pushteti Lokal. Kjo do të vlejë dhe për pronën shtetërore.

2.9 Volumet e punës dhe Preventivi

2.9.1 Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit, Kontraktori do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).

2.9.2 Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë çmimet njësi të Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit, në fuqi. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar do të shoqërohen me analizën e llogaritjes çmimit.

2.9.3 Preventivi do të shoqërohet edhe me grafikun e punimeve.

2.10 Pergatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit

2.10.1 Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsytet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

2.10.2 Në raportin përfundimtar do të përfshihet baza e projektimit të çdo elementi të punimeve, llogaritjet bazuar në projektin final dhe referencat e staniarteve të aplikuar.



2.10.3 Bashkëngjitur me këtë raport do të jenë në origjinal të gjitha miratimet, lejet apo propozimet e aktorëve pjesëmarrës dhe të interesuar si: Pushteti Lokal, ZRPP, ALUIZNI, DPUK, KESH, ALBTELEKOM, KKA (Keshilli Kombëtar i Arkeologjisë) Ministria e Mjedisit, etj.

2.10.4 Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të ketë datë dhe të jetë i firmosur nga Kontraktori dhe do të paraqitet në formë zyrtare tek Autoriteti Kontraktual për shqyrtim dhe miratim.

2.11 Vizatimet

2.11.1 Kontraktori në fazën e projektit të zbatimit duhet të përgatise dhe dorëzoje vizatimet e mëposhtme si pjesë e dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Horografia në shkallën 1: 5 000. Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme.
- Planimetria ekzistuese në shkallë 1:1000; 1:500
- Planimetria e propozuar në shkallë 1:500
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100 dhe H 1;500 V 1:100
- Profila tërthore SH 1: 100; 1: 200
- Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50
- Harta e rievimit topografik SH 1:1 000; 1:500; 1:200
- Harta hidrologjike SH 1:1000
- Zonat ku do të merren materialet e ndërtimit lëndë e parë përfshirë dhe punimet e përkohëshme vendet e depozitimive etj SH 1:1000
- Harta gjeologjike SH 1:1000; 1:500; 1:200.
- Vizatime të mureve mbajtës apo pritës dhe detaje të tyre, etj SH 1: 50; 1: 100
- Vizatime të veprave të artit, (tombino, ura, etj.) dhe detaje të tyre
- Planin e profilet për linjat KUZ e KUB dhe detajet e tyre, nese ka
- Planin e profilet për linjat elektrike dhe telefonike dhe detajet e tyre, nese ka
- Planin e profilet për gjelberimet, pejsazhin dhe detajet e tyre, nese ka
- Planimetritë e shpronësimeve SH 1:1000; 1:500
- Planimetria e sinjalistikes e detaje të saj
- Detaje të tjera
- Grafiku i punimeve

2.12 Gjurma e propozuar e rruges

2.12.1 Duke perdorur si baze gjurmen e rruges ekzistuese (ne rastin e rehabilitimeve dhe rindertimeve), profilin dhe llojin e terrenit te nxjerre ngaurvejimet topografike, Kontraktori duhet te pergatise nje projekt final duke perfshire intersektimet, afersine me rruge te tjera dhe zonat urbane. Ne realizimin e ketij projekti, pritet qe Kontraktori te perdore programe kompjuterike lehtesuese ne projektimin e rruges. Duhet bere gjithashtu ri-projektimi i gjurmes ne menyre qe te lehtesoje kthesat e forta, per sigurimin e shikueshmerise, etj. Elementet e profilit terthor duhet te projektohen ne perputhje me udhezimet e projektimit te rrugeve.

2.12.2 Nje Raport teknik, si pjese e Raporteve te Detajuara te Projektit, do te pershkruaj bazen e projektit gjeomerik, projektimin e shtreses, llogaritjet hidraulike per cdo strukture, projektimin strukturor, etj. Kjo do te perfshije gjithashtu vleresimin e projektit nga menaxheri i kontrates per miratimin e alternatives me te mire ekonomike duke marre parasysh pershtatshmerine e tyre gjate ekzekutimit dhe menaxhimit te trafikut ne terrene kodrinore.

2.12.3 Vizatimet per planimetrite e kryqezimeve, prerjet ne zonat urbane dhe karakteristika te tjera te rendesishme do te pergatiten ne nje shkalle te pershtatshme me te madhe me instalimet e nevojshme dhe informacionin e drenazhit. Per zonat urbane duhet te jepen detajet e sherbimeve, drenazhimi, zonat e parkimit, trotuaret, ndricimi, etj. Duhet te realizohen vizatimet standarte per shenjat e trafikut, vijezaime dhe karakteristika te tjera te kontrollit dhe sigurise se trafikut, puseta per fibra optike, struktura drenazhi te vogla dhe elemente te tjere te vegjel.

2.13 Shtresat - Projektimi i paketes se shtresave duhet te pergatitet bazuar ne:

- Standartet e projektimit dhe ngarkesat e trafikut, percaktuar nga Kontraktori;
- Ne gjetjet e investigimit gjeoteknik dhe gjendjes se rruges te vleresuara nga Kontraktori, te ndermarra sipas paragrafit 2.4, integruar me te dhenat e disponueshme nga databaza e shtetit (aty ku eshte e mundur); dhe
- Deflektori i rruges i matur sipas paragrafit 2.4.

2.14 Sistemi i Drenazhimit dhe Punimet Mbrojtese

2.14.1 Sistemi gjatesor i drenazhimit i integruar me sistemin terthor te tij do te zbatohet ne te gjitha gjatesine e projektit. Projektimi i drenazhit duhet te perfshije integrimin e drenazhit te rruges me sisteme te tjera drenazhi (nese ka) si dhe projektimin e drenazhit per kryqezime.

2.14.2 Te tregohet kujdes ne zgjidhjet teknike te drenazheve gjatesore neper kryqezime te rruges. Per seksione te rruges me karakteristika specifike duhet te parashikohen sisteme drenazhimi te posacme.

2.15 Punime bio-inxhinjerike

2.15.1 Do te vleresohen teresisht nga Kontraktori kerkesat per punime mbrojtese per te siguruar qendrueshmerine e skarpatave dhe rezistencen e dheut ndaj erozionit pergjate ndonje terreni me potencial rreshqites dhe shtresave te dheut te pakonsoliduara, pergjate rruges dhe duhet te behen parashikime te sakta per veprat bio - inxhinjerike.



2.15.2 Punimet bio-inxhinierike duhet te zgjidhen sipas tipit te bimesise, vendodhjes dhe detajeve te tjera, ne specifikime dhe vizatime. Punimet mbrojtese do te perfshijne gjithashtu mbrojtjen e rrjedhes se sipërme/poshtme ujore qe pershkon rrugen.

2.16 Strukturat

2.16.1 Duhet pergatitur projekte te detajuara te strukturave. Projektet do te hartohen per te maksimizuar perdorimin e komponenteve standarde dhe projekteve te strukturave. Ne veçanti per struktura te vogla; tombino rrethore apo box, struktura te mbikalimeve apo nenkalimeve, etj. me alternativa te preferuara te parafabrikuara.

2.16.2 Nenstrukturat do te dimensionohen mbi bazen e investigimeve te detajuara ne terren duke reflektuar praktiken me te mire nderkombetare. Ne zgjedhjen e tipit te themeleve Kontraktori duhet te marre parasysh gjithashtu kohen e kerkuar per ndertimin e aleternativave, dhe ti japi perparesi atyre qe shkurtojne kohen e ndertimit. Projektimi i urave duhet te marre parasysh kerkesen per trotuar per kembesoret dhe levizjen e bagetive.

2.16.3 Puna e projektimit do te kryhet ne perputhje me praktikat e pranueshme nderkombetare (si psh. Eurocodet siç jepet ne Sek 4 te draftit ARDM5.1) dhe do te perdore teknikat kompjuterike. Sizmika dhe te dhena te tjera do te merren parasysh sipas nevojës.

2.17 Mjetet e Sigurise Rrugore, Kontrollit te Trafikut dhe Facilitete te Tjera

2.17.1 Rekomandimet per siguri ne rruge do te integrohen ne projektin inxhinierik ne formen e planimetrive te permiresuara te kryqezimeve, arranjshimin e kufizueseve te trafikut per uljen e shpejtesise se automjeteve, facilitetet per kembesoret, vijejimi i rruges i permiresuar dhe instalimi i shenjave te trafikut, delineatoret e rruges, spotet fluorishente dhe çdo zbutes tjetër trafiku dhe/ose mjete te sigurise rrugore te menduara te nevojshme nga Kontraktori.

2.17.2 Planimetrit e vijizimit te rruges dhe shenjave te trafikut do te pergatiten per levizjen e sigurt dhe efikase te trafikut. Te dyja duhet te bazohen ne praktikat nderkombetare per rruge te tipit te tille, rregulluar sipas diskutimeve me Autoritetin Kontraktor te permbushi Kodin e Rruges Shqiptare aktual: "RREGULLORE PER ZBATIMIN E KODIT RRUGOR" (zbatimi i kodit rrugor) Vol. II "STANDARTET E SINJALIZIMIT RRUGOR" dhe draft Manualit te Projektimit te Rruges per Shqiperine ARDM6.

2.17.3 Duhet te pergatiten projektet e ndriçimit te rruges per seksionet brenda zones urbane dhe zona te tjera ku eshte i nevojshem ndriçimi.

2.18 Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis - Projekt zbatimi do te permbaje edhe Raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM), hartuar ne perputhje me kerkesat e renditura ne Aneksin 6.

3. Specifikimet Teknike dhe Planet e Ndertimit

3.1 Kontraktori do te rishikoje specifikimet teknike ekzistuese, bazuar ne standartet me te mira kombetare dhe nderkombetare, per te gjitha aspektet e punimeve, dhe do te reflektojë ndryshimet e nevojshme, bazuar ne diskutimet me Autoritetin Kontraktor dhe Mbikqyresin e punimeve (me kete te fundit, kur kjo eshte e mundeshme).



3.2 Kontraktori do te pergatise planin e menaxhimit te trafikut dhe sigurise, ashtu sikurse planet e zbatimit gjate fazes se ndertimit, per te siguruar rrjedhshmerine dhe uljen e intesitetit te trafikut dhe sigurine ne zonen e ndertimit.



Kerkesat e Pergjithshme per hartimin e projekteve teknike te detajuara te objekteve ndërtesa

1. Projekt - ideja

1.1 Në studimin e këtij objekti Kontraktori duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nënvariate të tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme ti paraqesë.

1.2 Gjatë kësaj faze Kontraktori duhet të përfshijë dhe aktivitetet e mëposhtme:

- Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamëndshmërisë të bëra gjatë fazave më të hereshme
- Përditesimin e llogaritjeve dhe zevëndësimin e hamëndësimeve të bëra më parë
- Pergatitjen e metodollogjisë së përgjithshme të ndërtimit
- Pergatitjen e grafikut paraprak te programit të punimeve
- Pergatitjen e vlerësimit paraprake të kostos
- Ndikimet ndaj mjedisit
- Konsultimin me publikun

1.3 Kontraktori duhet te paraqese variantet e ndërhyrjes, në bazë të rezultateve të vlerësimit të konstruksioneve mbajtëse, duke përfshirë dhe konceptimin e ndarjes së ambjenteve të brendshme në varësi të funksionit të tyre me argumentimet përkatëse. Gjithashtu, Kontraktori mund të paraqise variant-ide të sistemeve teknologjike bashkekohore, etj.

1.4 Variantet e propozuara duhet të paraqiten te shoqeruar me preventivat paraprake dhe specifikimet përkatëse.

1.5 Studimi Topografik - Për këtë qëllim do të kryhet një rilevim topografik (i relievit dhe kuotave të terrenit) i cili do të hartohet nga Kontraktori dhe duhet të jetë i firmosur dhe vulosur edhe nga specialisti topograf.

1.6 Studimi Gjeologjik - Studimi gjeologjik duhet të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e dherave dhe formacioneve. Veçanërisht, rëndësi duhet ti kushtohet studimit të vendeve ku do të parashikohen ambjente nentokesore. Studimi do të shoqerohet dhe me fotografi të cilat së bashku me hartat dhe shpimet e kryera do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në studimin gjeoteknik. Studimi do të ketë datë dhe duhet të jetë i konfirmuar nga specialisti gjeoteknik apo grupi i projektimit gjeoteknik.

1.7 Studimi Hidrologjik - Ne studimin hidrologjik duhen të vlerësohen kushtet hidrologjike te zones duke përfshirë dhe studimin e drenazhimit të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Në



përfundim të këtij studimi do të përgatitet Raporti Hidrologjik i cili do të ketë datë dhe të jetë i firmosur.

1.8 Metodologjia e Ndërtimit - Kontraktori do të përshkruajë për këtë fazë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikpamja teknike, logjistike dhe programore në përputhje me elementët teknikë të projektit dhe rekomandimet e VNM. Këtu duhen theksuar rreziqet e veçanta në të cilat do të ndeshet kontraktori dhe menyrat se si do të perballohen ato prej tij. Ky raport do të ketë datë dhe të firmoset nga drejtuesi i projektit apo grupi i projektimit.

1.9 Raporti i Shpronësimeve - Ky raport do të paraqesë një listë të mundëshme shpronësimesh për të gjithë variantet që propozohen së bashku dhe me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotesohen në lidhje me projektin.

1.10 Kërkesat për leje apo licensa - Në këtë raport Kontraktori do të raportojë për lejet apo kërkesat që duhen marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

1.11 Raporti mbi konsultimin e publikut - Ky raport do të përmbledhë të gjitha propozimet e konsultimit me publikun, me aktorët tjerë të interesuar, me entet shtetërorë si Bordi i Kullimit, KESH, Ndërmarjet Ujës-jellës Kanalizime, Telekom, Monumentet e Kulturës, institucionet apo organizmat arkeologjike, etj.

1.12 Vizatimet


Kontraktori duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme si pjesë bazë e dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Raportin Teknik
- Projektin arkitektonik, relacionin arkitektonik të objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambjenteve, Plani i taracës, etj.
- Konstruksionin e objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- Projektin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit
- Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- Grafikon e punimeve
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- Relacionin gjeologjik për shtesat e reja të parashikuara
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

1.10 Volumet e punës dhe Preventivi

Kontraktori do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt. Volumet do të llogariten në bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet mesatare të Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit, në fuqi. Ato zera që nuk gjenden në manuale duhet të shoqerohen me analiza teknike.

1.11 Projekt-Ideja në këtë fazë do të përmbillet me raportin teknik në të cilin përmbidhet i gjithë procesi i të menduarit që ka shërbyer si bazë e punës për hartimin e Projekt-Idesë. Në të



përfshihen planimetritë dhe informacione tjera të rëndësishme sic janë studime të veçanta, foto, etj. Raporti i Projekt-Idese mbasi firmoset dhe vulosem nga Kontraktori paraqitet tek Autoriteti Kontraktues, në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim.

2. Projekt – Zbatimi

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktues, Kontraktori do të hartojë projektin e zbatimit, i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për zbatim.

2.1 Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

2.1.1 Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj të zbatimit të punimeve. Studimi duhet të përmbajë informacion për ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe strukturat e drenazheve.

2.1.2 Për të kryer survejimin topografik, Kontraktori do të perdore Total Station, GPS ose pajisje të ngjashme me të në teknike dhe procedura, të cilat zhvillohen në kompjuter, në baze të modelimit topografik të terrenit.

2.2 Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik dhe Investigimit të Materialeve

2.2.1 Kontraktori në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dalë gjatë shqyrtimit të projekt-idesë pranë Autoritetit Kontraktues.

2.2.2 Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- tekstin e raportit, parametrat gjeoteknikë të projektimit;
- materialin grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të veçantë të shpimeve;
- cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues (nese ka);
- konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

2.3 Investigimet Hidrologjike dhe Hidraulike

2.3.1 Kontraktori duhet të bëjë një studim me të dhëna shtesë të vlefshme dhe të nevojshme mbi hartën topografike, kohezgjatjes së rreshjeve, statistikave të tyre, karakteristikave të dheut, bimesisë etj, në mënyrë që të ketë akses në zonën ujembledhëse si dhe parametrat hidraulikë për të gjitha strukturat dhe tobinot ekzistuese dhe të reja që do të parashikohen në projekt.

2.3.2 Kontraktori do të mbledhë informacion mbi nivelet e permbytjes, kuotën e ulet të ujërave, shpejtësinë e shkarkimit etj, nga të dhëna të mëparshme të disponueshme, nga raporte të investigimit ekzistues dhe shënja të dukshme në terren.

2.4 Investigimi i Sherbimeve Publike



Kontraktori duhet të mbledhe detaje të çdo parametri fizik përgjate gjurmes së rruges, duke përfshirë ndërtesat dhe strukturat, monumentet, varrezat, vendet religjioze (shenjtja), linjat e hekurudhes, linjat e shtyllat elektrike e të telefonise, shërbimet nentokesore, vendodhjet e pusëtave, si dhe tipe të tjera shërbimesh si p.sh: fibra optike, pusëtat e shiut, ujerave të zeza, tubacione të gazit/naftes në menyren e duhur dhe që pritet të preken nga ndërtimi i rruges. Informacioni i mbledhur duhet të paraqitet në një plan zhvendosjesh në menyre që zgjatja e afatit të dorëzimit dhe rivendosja e strukturave dhe shërbimeve të mund të vleresohen në menyre të përshtatshme. Plane zhvendosjeje të ndara për çdo shërbim (energji, telefon, uje etj.) të përfshirë, duhet të përgatiten për të lehtësuar kështu koordinimin me agjensite në ngarkim.

2.5 Përgatitja e metodologjise përfundimtare të punimeve të ndërtimit

2.5.1 Mbas përpunimit të projektit dhe hartimit të projektit përfundimtar të zbatimit, Kontraktori duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet të referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje kontraktori.

2.5.2 Kontraktori do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes së materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre.

2.5.3 Në këtë fazë gjithashtu, Kontraktori do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të spostimeve të ndryshme elektrofonike apo të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.

2.5.4 Kontraktori do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra gjatë zbatimit të punimeve për sigurinë në punë.

2.6 Raporti përfundimtar i shpronësimeve

Kontraktori në këtë fazë do të rishikojë investigimet e kryera në fazën e projekt-idesë duke përshkruar tashmë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen sipërfaqet e objekteve apo trojeve të bashkëngjitura me planimetritë e objekteve dhe gen-planet e trojeve, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit.

Bashkëngjitur me këto të dhëna do të jenë dhe miratimet e Zyrave të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo në mungesë të dokumenteve të pronësisë, ato të ALUIZNIT apo çdo miratim tjetër nga Pushteti Lokal. Kjo do të vlejë dhe për pronën shtetërore.

2.7 Volumet e punës dhe Preventivi

2.7.1 Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit Kontraktori do të hartojë një listë të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi)

2.7.2 Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyren e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë çmimet njësi të Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit, në fuqi. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar, duhet të shoqërohen me analizën e llogaritjes së çmimit.

2.7.3 Preventivi do të shoqërohet edhe me dhe grafikun e punimeve.



2.8 Pergatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit

2.8.1 Raporti i projektit përfundimtar të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mëposhtem si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

2.8.2 Raporti duhet te përmbaje:

- Raportin teknik të projektimit arkitektonik.
- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.), si dhe masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, si siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit etj. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e Autoritetit Kontraktues.
- Relacionin sizmiologjik të truallit (kur nuk ka studim, një përshkrim i përgjithshëm)
- Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Preventivi i plotë.

2.8.3 Bashkëngjitur me këtë raport do të jenë në origjinal të gjitha miratimet, lejet apo propozimet e aktorëve pjesmarrës dhe të interesuar si Pushteti Lokal, ZRPP, ALUIZNI, DPUK, KESH, ALBTELEKOM, KKA (Keshilli Kombëtar i Arkeologjisë), Ministria e Mjedisit, etj.

2.8.4 Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të ketë datë dhe të jetë i firmosur dhe do të paraqitet në formë zyrtare tek Autoriteti Kontraktual për shqyrtim dhe miratim.

2.9 Vizatimet përfundimtare

2.9.1 Kontraktori në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të pergatise e dorezoje vizatimet e mëposhtme si pjesë bazë e dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

2.9.2 Vizatimet përfundimtare te projekt zbatimit duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

- Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
- Planimetria e përgjithëshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
- Planimetritë e kateve egzistuese (nese ka) Shk. 1:100, 1:50
- Planimetritë e objektit pas ndryshimeve Shk. 1:100; 1:50
- Fasadat egzistuese Shk.1:100
- Fasadat e reja në 2D dhe 3D Shk.1:100
- Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
- Planimetria e themeleve Shk.1:100
- Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
- Plani i strukturave e detaje Shk.1:100; Shk.1:50
- Planimetritë e mobilimit Shk.1:100



- Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
- Planimetria e furnizimit me ujë në Shk. 1: 200, 1:100
- Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
- Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
- Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
- Planimetria dhe detaje të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
- Planimetria e dhomës së kaldajës (nese ka), konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
- Planimetri dhe detaje për ndriçimin (fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj.) Shk.1:100;1:50
- Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objektin, Shk. 1:100
- Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e ambjenteve sportive dhe ambjenteve të gjelbëruara dhe detaje Shk.1:100; 1:50
- Planimetria e murit rrethues, tipin dhe detajin e fiksimit të stolave Shk.1:100; 1:50.
- Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujrave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
- Detaje të tjera
- Grafiku i punimeve

2.10 Raporti i vleresimit të ndikimit në mjedis - Projekt zbatimi do të përmbajë edhe Raportin e vleresimit të ndikimit në mjedis (VNM), hartuar në përputhje me kërkesat e renditura në Aneksin 6.

3. Kërkesa mbi kriteret konstruktive dhe funksionale


3.1 Themelet

3.1.1 Në rastet kur projekti parashikon rikonstruksionin e godinës si dhe zgjerime volumetrike në lartësi, kusht themelor dhe detyrë parësore teknike është verifikimi i themeleve të godinës ekzistuese si dhe përlllogaritja paraprake e aftësisë mbajtëse të tyre. Këtu përfshihet lloji i materialit me të cilin janë realizuar, përmasat, modalitetet e realizimit të tyre. Në varësi të gjithë këtyre parametrave, të vetive fiziko-mekanike si dhe të thellësisë së tyre, Kontraktori duhet të përcaktojë të gjitha mënyrat dhe mundësitë e ndërhyrjes në to.

3.1.2 Në rastet kur projekti parashikon ndërtimin e një objekti të ri, është e domosdoshme përcaktimi i vetive fizike dhe mekanike të dherave dhe masave gjeologjike që përcaktojnë terrenin, ku parashikohet të ngrihet ndërtesa në fjalë. Është e këshillueshme ideimi, si dhe verifikimi i tyre, edhe në rastet kur parashikohet realizimi i ambjenteve nëntokesore.

3.2 Konstruksioni beton, b/a e soletat - Është detyrë e Kontraktorit të zbatojë kushtet teknike të projektimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, specifike për objektin në fjalë, si dhe standardet e miratuara lidhur me materialet që do të përdori.

3.3 Tarraca



3.3.1 Kontraktori duhet të japë të gjitha detajet për hidroizolim dhe termoizolim dhe për mënyrën e ngjitjes së shtresës hidroizoluese në parapetin e tarracës, për vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukët vertikalë, si dhe detaje të tjera të domosdoshme për zbatimin e punimeve.

3.3.2 Kontraktori duhet të tregojë skemën e kullimit me pjerrësitë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre sipas normave në fuqi.

3.3.3 Në rastet e rikonstruksionit të godinave ekzistuese dhe shtesave të ambienteve, ndërhyrja për riparimin e çatisë/terraces duhet projektuar në përputhje me tipin e godines. Për sasitë e reshjeve do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik.

3.4 Muret

3.4.1 Kontraktori duhet të zbatojë kushtet teknike të projektimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, specifike për objektin në fjalë si dhe standardet e miratuara lidhur me materialet që do të përdori.

3.4.2 Kontraktori do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme dhe/ose në rastin kur kërkohet shtesë kati. Në rast të mureve me çarje, Kontraktori do të tregojë mënyrën e riparimit/konsolidimit të tyre.

3.5 Suvatimet e lyerjet

3.5.1 Objekti duhet të suvatohet e lyhet nga brenda dhe jashtë. Është detyrë e Kontraktorit të zbatojë kushtet teknike të projektimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, specifike për objektin në fjalë si dhe standardet e miratuara lidhur me materialet që do të përdori.

3.5.2 Në objektet që ristrukturohen, pjesët e dëmtuara, suvatimet e brendshme e të jashtme do të kryhen në të gjithë sipërfaqen përkatëse, në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti.

3.6 Fasada – Kontraktori duhet të zbatojë kushtet teknike të projektimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, specifike për objektin në fjalë, si dhe standardet e miratuara lidhur me materialet që do të përdori.

3.7 Shtresat e dyshemese

3.7.1 Kontraktori duhet të përcaktojë që materialet e shtresave që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Kontraktori duhet të zbatojë kushtet teknike të projektimit, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, specifike për objektin në fjalë si dhe standardet e miratuara lidhur me materialet që do të përdori.

3.7.2 Në varësi të tipit të projektit, ndërtim i ri apo rikonstruksion dhe funksionit të objektit përcaktohen detajet e shtresave të dyshemese e kateve.

3.7.3 Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izolohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre.

3.8 Shkallët



Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet si dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projekt zbatimit. Eshte e nevojshme përcaktimi i qartë i gjendjes së shkallëve, si nga ana funksionale në lidhje me kapacitetin e ri të tyre ashtu edhe nga pikëpamja konstruktive ose e aftësive mbajtëse të konstruksionit në rastin e rikonstruksionit të godinës.

3.9 Dyer e dritare

3.9.1 Kontraktori duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. Nëse janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë, me mentesha të forta (minimumi tre për çdo derye). Vendosja e deryeve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejte në raste emergjencash, sipas standarteve.

3.9.2 Dritaret do të jenë të cilësisë së lartë, me hapje me rrotullim dopio-xham dhe me sopralluce në ambjete që e kërkojnë ato. Gjithashtu për katet e para, duhet të jenë të parashikuara të gjitha normat e sigurisë, pra edhe pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës perkates.

3.10 Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve

3.10.1 Kontraktori duhet të marrë në konsideratë rrjetin ekzistues të kanalizimeve të zonave ku ndodhen objektet, si edhe projektin e ri të kanalizimeve për këto zona (nese ka).

3.10.2 Rrjeti i ujësjellësit dhe ai i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi.

3.10.3 Duhet të parashikohet rrjeti i ujësjellësit për godinën për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

3.10.4 Materialet që do përdoren për rrjetin e ujësjellësit do të llogariten për aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

3.10.5 Duhet të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre në më të paktën dy prej lavamanëve dhe sanitarëve (WC) si dhe depozitat e ujit për MNZ.

3.11 Rrjeti elektrik, telefonik dhe kompjuterik

3.11.1 Projekti duhet të përmbajë të gjitha detajet dhe specifikimet teknike të domosdoshme për fazën e projektit të zbatimit.

3.11.2 Kontraktori duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Kontraktori duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve, si dhe dimensionet e vidave që duhet të përdoren. Panellet e komandimit duhet të vendosen të rinj sipas standarteve bashkëkohore.

3.11.3 Në rastet kur parashikohet shtimi i ambjenteve të reja, për shkak të rritjes së fuqisë së instaluar në objekt, rrjeti elektrik ekzistues nuk e përballon ngarkesën për funksionimin e kaldajës dhe gjithë sistemit të ngrohjes. Në këto kushte, Kontraktori duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionimin normal të sistemit



të ngrohjes. Në rast se del e nevojshme që të ndërtohet kabinë e re elektrike, duhet të parashikojë projekt/preventivin e saj.

3.12 Sistemi elektrik, ndriçimi i emergjencës dhe sigurisë

3.12.1 I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin perdhe, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit.

3.12.2 Nuk lejohet që tubacionet e sistemeve të tjera (ngrohjes, ujit të ngrohtë, etj.) të vendosen në të njëjtin kanal.

3.13.3 Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni.

3.14 Sistemi i mbrojtjes atmosferike

3.14.1 Objektet duhet patjetër të kenë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjendet në një zonë me shkarkime atmosferike te shumta.

3.14.2 Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

3.15 Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Kontraktori duhet të parashikojë sistemin ngrohës dhe të ventilimit atje ku është i nevojshëm, bazuar në kushtet e standardet e projektimit.

3.16 Sistemi i mbrojtjes nga zjarrit (MNZ)

Kontraktori duhet të parashikojë sistemin e mbrojtjes nga zjarri, atje ku është i nevojshëm, si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve të projektimit.

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në koridore dhe në ambientin teknik.

3.17 Kalimet e emergjencës, shkallët, koridoret

Kontraktori duhet të parashikojë kalimet e emergjencës nëse është e nevojshme bazuar në normat dhe standardet e projektimit.

3.18 Sistemit e jashtme, ambientet e gjelbëruara

3.18.1 Sistemimeve të objektit duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë. Ato duhet të projektohen në përputhje me të gjitha normat e sigurisë dhe standardet e projektimit. Ambientet e jashtme janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë. Kontraktori duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre.

3.18.2 Kontraktori duhet t'i japë rëndësi dhe të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin urbanistik të zones dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rjetin e ndriçimit të kërkuara në detyrën e projektimit.


Infrakonsult
konsulencë inxhinierie
Tirana - Albania


deastudio
Shërbime dhe Konsultime të Integruara
Tirana - Albania

3.18.3 Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet, sistemimit dhe disiplinimit të ujrave sipërfaqesore.

4. Specifikimet Teknike dhe Planet e Ndertimit

4.1 Kontraktori do të rishikojë specifikimet teknike ekzistuese, bazuar në standartet me të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, për të gjitha aspektet e punimeve, dhe do të reflektojë ndryshimet e nevojshme, bazuar në diskutimet me Autoritetin Kontraktor dhe Mbikqyresin e punimeve (me këto të fundit, kur kjo është e mundur).

4.2 Kontraktori do të përgatisë planin e menaxhimit të trafikut dhe sigurisë, ashtu sikurse planet e zbatimit gjatë fazës së ndërtimit, për të siguruar rrjedhshmërinë dhe uljen e intensitetit të trafikut dhe sigurinë në zonën e ndërtimit.

Aneksi 6

Kerkesat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)

1. Kerkesat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

1.1 Vlerësimi mjedisor duhet të kryhet në përputhje me ligjin shqiptar nr. 10 440, për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", duke u bazuar dhe në konventën e Aarhus-it të cilën Shqipëria e ka nënshkruar. Kontraktori do:

(a) të paraqesë në organet përkatëse të gjitha projektet për të identifikuar nëse ato kërkojnë një raport të "Thelluar" ose "Paraprak" të VNM-së (në varësi të tipit të projektit) bazuar në ligjin shqiptar dhe të informojë zyrtarisht autoritetin kontraktues. Kontraktori duhet t'i referohet shtojcave, për çdo projekt specifik, për të përcaktuar llojin e VNM-së parashikuar në Ligjin nr. 10440, ose aktet pasuese të tij.

(b) të kryejë procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (p.sh. VNM të thelluar apo paraprak) të garantuar nga rezultatet e kontrollit duke përfshirë marrjen e informacioneve bazë mjedisore dhe sociale, duke vlerësuar ndikimet e mundshme, masat zbutëse, të cilat duhet të jenë të përmbajtura



në Planin e Menaxhimit Mjedisor, si dhe në organizimin e konsultimit me publikun bazuar në kërkesat e konventës së Aarhusit.

1.2 Objektivat e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis janë:

1.2.1 Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur.

1.2.2 Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj.

1.2.3 Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

1.2.4 Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e:

- efekteve të pritshme të masave të propozuara.
- ndikimet e identifikuara dhe masat zbutese perkatëse paraqiten në Planin e Menaxhimit të Mjedisit, bashkëngjitur raportit VNM.

1.3 Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- proçesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

1.4 Dokumenti bazë, ku mbështetet proçesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II të ligjit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I të po këtij ligji.

1.5 Kontraktori duhet të paraqesë një përshkrim të plotë të projektit ku duhet të përfshijë:

- Arsyet e propozimit të projektit;
- Marrëdhëniet me projektet e tjera ekzistuese apo atyre të planifikuara.
- Njësitë administrative ku kalon projekti.
- Përputhja e projektit me planet e zhvillimit dhe politikat mjedisore lokale ose rajonale, statusi i zonave ku kalon projekti (zonat e mbrojtura, kategoria), etj.

1.6 Në përshkrimin e projektit (raporti teknik), duhet të përfshihen punimet në terren, vendodhjet, shtrirjet kryesore, ndihmesat mbështetëse (psh: ndërtimi i kampeve, etj.) punimet



jashtë kantierit, siç janë: gjurmimet, rrugët ndihmëse, hedhjen e mbetjeve, programin e punës së stafit.

1.7 Përshkrimi i gjendjes së mjedisit ku kalon projekti, përfshin një përshkrim të:

- Mjedisit fizik të zonës ku kalon projekti (gjeologjinë, gjemorfologjinë, tokat, klima, hidrologjia, ujrat sipërfaqësore dhe nëntoksore, trashëgimia arkeologjike e kulturore, peisazhi dhe bukuritë pamore).
- Mjedisit biologjik (përshkrimi i faunës, florës dhe statusi i mbrojtjes së llojeve të pranishme në zonë);
- Mjedisi human, përshkrimi i gjëndjes social-ekonomike, cilësia e ajrit dhe niveli i zhurmave;
- Përdorimi i tokës që preket nga projekti.

1.8 Analizimi i alternativave:

1.8.1 Kontraktori duhet të paraqese krahasimin ndërmjet alternativave të propozuara të projektit, teknologjisë, dhe funksionimit, duke përfshirë këtu edhe alternativë “pa projekt”, në lidhje me ndikimet e tyre potenciale në mjedis, fizibilitetin e zbutjes së këtyre ndikimeve, koston, përshtatjen e tyre në lidhje me kushtet lokale, si dhe kërkesat e tyre për përsa i përket monitorimit.

1.8.2 Jep përshkrim përmbledhës të alternativës kryesore të vlerësuar nga Kontraktori, me tregues të arsyeve kryesore të përzgjedhjes së alternativës, bazuar në studimin e ndikimit në mjedis.

1.9 Vlerësimi i ndikimeve përfshin:

- Ndikimin në mjedisin fizik.
- Ndikimin në biodiversitet.
- Ndikimin social-ekonomik.
- Ndikimet kumulative (hapësirë dhe kohë).

1.10 Njëkohësisht Kontraktori duhet t’i kushtojë një vëmendje të veçantë:

- Humbjes së tokës bujqësore (nga ndikimet direkte apo indirekte)
- Shkatërimit apo dëmtimit të zonave të ndjeshme ekologjike (ligatina, pyje apo habitate të tjera natyrore)
- Problemeve sociale të rivendosjes

1.11 Masat mjedisore lehtësuese - duhet të projektohen për të lehtësuar ndikimet negative të mundshme dhe për të reduktuar ato deri në nivel të pranueshëm, siç mund të përcaktohen prej standarteve të aplikueshme.

1.12 Plani i menaxhimit mjedisor - paraqet një grup masash dhe përgjegjësish gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit për të eliminuar ose për të zbutur ose kontrolluar, ndikimet mjedisore dhe ndikimet sociale që vijnë nga ndërtimi i rrugës.



1.13 Plani i monitorimit të mjedisit - bazohet në mbikqyrjen e menaxhimin e mjedisit dhe do të kryhet periodikisht për të monitoruar komponente specifike dhe për të siguruar të dhëna që japin madhësinë e nivelit të ndikimeve.

1.14 Konsultimi publik

1.14.1 Ligji nr. 10440, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", si dhe aktet nenligjore te tij, si per shembull "Vendim i Keshillit te Ministrave, dt. 30.04.2014 per percaktimin e rregullave, kerkesave dhe procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore", percakton rolin dhe te drejtat e publikut ne ceshtjet e mjedisit. Kontraktori, ne bashkepunim me Autoritetin Kontraktues dhe me pushtetin lokal, ka per detyre organizimin e konsultimeve me publikun, brenda afatit te përfundimit të studimit.

1.14.3 Kontraktori do të përgatisë raportin e VNM me staf të licencuar nga institucioni përgjegjës (person fizik apo juridik) për vlerësime të ndikimit në mjedis, të licencuar nga QKL dhe të regjistruar në QKR.

Aneksi 7

Kerkesat per planet e shpronësimit

Planet dhe programet e shpronësimit

1. Kontraktori duhet të kryejë të gjitha detyrat e nevojshme në mënyrë që t'i paraqesë dokumentacionin e mjaftueshëm Autoritetit Kontraktor që lejon procedurën e shpronësimit për shpronësimin e tokës dhe pronave të prekura nga fillimi i një projekti.

Detyrat e Kontraktorit janë ilustruar më poshtë:

- Përcaktimi i kufijve të tokës: E gjithë puna e studimit të projektit duhet të jetë e bazuar në Sistemin e Rrjetit Kombëtar Shqiptar. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe me miratimin me shkrim nga Autoriteti Kontraktues, do të lejohet një tjetër sistem koordinimi.
2. Kufijtë e shpronësimit do të shënohen me 1.0 metër lartësi, 50 mm katror, në piketa prej druri pikturuar me të bardhë. Ato do të përcaktojnë në mënyrë të qartë kufirin e secilës ngastër toke për t'u shpronësuar dhe do të vendoset në një minimum prej 50 metër hapësirë. Duhet të përcaktohen koordinatat për të gjithë kufijtë e shpronësimit. Kufijtë duhet të tregohen në hartat e shpronësimit.
3. Shenjat e kufijve do t'u dorëzohen përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor. Nëse kërkohet, dorëzimi të Autoriteti Kontraktor mund të zhvillohet edhe në seksione, sipas marrëveshjes.



4. Madhësia e pronave të ndryshme që duhet të shpronësohen duhet të matet në terren dhe informacioni mbi matjet duhet të regjistrohet në një formë të përshtatshme, mundësisht në një kopje në terren të planeve shpronësimit.

- Shpronësimi i tokës dhe Programi: Detajet e shpronësimit të tokës do të duhet të jenë të përfshira në hartat zyrtare të regjistrimit të tokës.

5. Për ato zona ku nuk ka harta aktuale të regjistrimit të tokës, Kontraktori duhet të përgatisë një plan të ri shpronësimi në një shkallë 1:500 ose 1:1000, e cila duhet të jetë e përshtatshme dhe mbi të cilën është rënë dakord. Emrat e pronarëve përkatës, vlerësimi i zonave të shpronësuara dhe sipërfaqet e zonave të rishikuara do të përfshihen në plan. Të gjitha pikat kufitare të pronës së shpronësuar duhet të bashkërendohen.

6. Plani i Shpronësimit të tokës gjithashtu duhet të përmbajë të dhënat themelore të nevojshme për shpronësimin e ndërtesave, strukturave, mure, pemë dhe pronave të tjera të prekura. Kontraktori duhet të studiojë pozicionin e këtyre objekteve dhe dhe ti hedhë ato në vizatime. Lloji i kultivimit dhe/ose përdorimi i tokës duhet gjithashtu të regjistrohet.

7. Kontraktori do të përcaktojë pronat dhe pronarët përkatës të tokës ngjitur me pronat që do të shpronësohen (pronësitë në Lindje-Perëndim-Veri-Jug) dhe që ndoshta mund të ndikohen nga aktivitetet e ndërtimit.

8. Në përgatitjen e planit të shpronësimit të tokës, Kontraktori duhet të marrë në konsideratë standardet teknike për matjet dhe hartat dhe duhet t'i aplikojë këto standarte.

9. Programi i shpronësimit të tokës duhet të përgatitet në përputhje me format e aprovuara nga Autoriteti Kontraktor. Ato duhet të japin me detaje emrin e pronarit dhe adresën, sipërfaqen e tokës që do të zihet dhe një inventar të përmbajtjes. Programet duhet të jenë të përgatitur në bashkëpunim me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme lokale, Autoriteteve Lokale, Departamenti i Regjistrimit të Tokës dhe të Departamentit të Planifikimit Urban të çdo Qarku. Kur identiteti i pronarit nuk mund të përcaktohet, duhet të identifikohet sipërfaqja e pronës dhe numri i regjistrimit në Regjistrin e Tokës.

10. Kontraktori do të përfshijë në një vëllim të veçantë raportin e shpronësimit të tokës në lidhje me çdo projekt të veçantë që permban të dhënat e mesiperme.



Kerkesat per raportimet dhe dorezimet e shërbimeve

1. Kerkesat per raportimet

Raportimi i detajuar dhe pergatitja e dorezimi ne kohe i sherbimeve eshte i rendesishem per Projektin. Ne vijim jane renditur raportet/sherbimet qe duhet te dorezohen periodikisht, afatet e dorezimit dhe nje pershkrim i permbajtjes se tyre. Keto jane dokumenta dinamike, subjekt ndryshimesh, per ti permiresuar ato apo per te reflektuar nevojat e Autoritetit Kontraktues.

- **Raporti i fillimit te punes** brenda 1 muaji nga fillimi i sherbimeve, per te detajuar ne teresi te gjithe organizimin e programuar dhe metodologjine qe do te perdoret per te ndermarre kryerjen e sherbimeve, duke perfshire nje plan te detajuar zbatimi, konfirmimin e stafit dhe komunikimet me Autoritetin Kontraktues.
- **Raportet Mujore** per Autoritetin Kontraktues, duke filluar dy muaj pas fillimit te punes, bazuar ne progresin e punes dhe çdo çeshtje tjeter te hasur gjate saj. Raportet do te detajojne aktivitetin per secilin objekt te veçante, duke perfshire çdo çeshtje, se bashku me çdo informacion tjeter te nevojshem.
- Per secilen kontrate punimesh nje **Raport projektimi** qe pershkruan punimet. Draftet e raporteve, per secilen kontrate punimesh, do ti dergohen Autoritetit Kontraktues sapa te pergatiten. Raportet finale do te dorezohen brenda 2 javeve nga marrja e komenteve nga Autoritetit Kontraktues. Kjo kohe perfshin dhe kohen e shqyrtimit nga Oponenca Teknike, ne rastet kur kjo kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi.
- Per secilin objekt nje **VNM dhe Plan Menaxhimi i Mjedisit** (nese eshte e nevojshme) qe pershkruan çeshtjet mjedisore dhe sociale dhe planin e menaxhimit dhe monitorimit te mjedisit per secilin objekt. Nje draft raport, per secilin objekt, do ti dergohet Autoritetit




Kontraktues sapo te pergatitet. Raportet finale do te dorezohen brenda dy javeve nga marrja e komenteve nga Autoriteti Kontraktues.

- Per secilin objekt (kur eshte e nevojshme) **Planet e Shpronesisimit**, duke perfshire dhe planet qe tregojne zonat e tokes te nevojshme per çdo projekt, nese kjo kerkohet per arsye sigurie (psh: ne rastin e rrugeve). Dokumentat draft, per secilen kontrate punimesh, do ti dergohen Autoritetit Kontraktues sapo te pergatiten. Dokumentat finale do te dorezohen brenda dy javeve nga marrja e komenteve nga Autoriteti Kontraktues.
- Per secilen kontrate punimesh nje pakete e **Dokumentave te Tenderit per punimet**, duke perfshire vizatimet, specifikimet teknike dhe preventivin. Dokumentat draft, per secilen kontrate punimesh, do ti dergohen Autoritetit Kontraktues sapo te pergatiten. Raportet finale do te dorezohen brenda dy javeve nga marrja e komenteve nga Autoriteti Kontraktues.

2. Kerkesat per dorezimin e dokumentacionit dhe sherbimeve

- Numri i kopjeve te printuara dhe dorezimi i raporteve dhe sherbimeve tek Autoriteti Kontraktor do te kryhet sipas tabelës se meposhtme. Çdo material do te dorezohet se bashku me nje kopje elektronike ne CD/DVD, sipas nevojës.
- Mbas kthimit të draft raportit me vërejtje nga Autoriteti Kontraktor dhe Oponenca, Kontraktori do te pergatisë dhe dorëzoje në rrugë zyrtare prane Autoritetit Kontraktor, projektin e plotë të zbatimit së bashku me Raportin Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivin përfundimtar.
- Dorëzimi i projektit të zbatimit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Projekti i zbatimit duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur në origjinal nga Kontraktori.
- Bashkëngjitur me projektin duhet të sillen edhe miratimet apo opsionet e pushtetit lokal ose të institucioneve të tjera, që kanë bashkëpunuar dhe që janë pjesëmarrës dhe aktorë në këtë projekt.
- Projekti i printuar do të dorëzohet në 5 (pesë) kopje të firmosura e vulosura në origjinal dhe në formatet e miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne varesi te llojit te projektit (A3 ose nje format tjetër i pershtatshëm).
- Raportet do të dorëzohen te printuara ne 5 (pesë) kopje të firmosura e vulosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara A4.
- Projekti i Zbatimit do të dorëzohet gjithashtu në dy kopje elektronike (në 2 CD/DVD)
 - 1 CD/DVD në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet AutoCad, Office etj. ku perfshihen projekti, raporti, preventivi dhe specifikimet teknike.
 - dhe 1 CD/DVD ne formatin PDF per tender.



Shtojca 4

STRUKTURA E PROPOZIMIT EKONOMIK

Emri i ofertuesit: **Bashkimi i operatoreve ekonomik “ Dea studio”shpk & “ Infrakonsult” shpk**

Për: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10, Tiranë

Procedura e prokurimit: **Sherbim konsulence - marreveshje kuader**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Durres.**

Publikimi : Buletini i Njoftimeve Publike *nr.2 dt.18 Janar 2016*


Duke ju referuar procedures se lartpermendur,ne, te nenshkruarit, deklarojme se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është një zbritje në masën 9.5 % mbi vlerën e fondit limit.
2. Çmimit total të ofertës sonë pa TVSH, i shtohet vlera e TVSH.
3. Çmimi i kontratës do të jetë në monedhën Lekë.

Përfaqësuesi i bashkimit

Nënskrimi

Vula





KONTRATE BASHKEPUNIMI

Sot me date 29/01/2016 (dymije gjashtembedhjete), para meje AIDA HOXHA notere ne qytetin e Tiranes, me seli si me siper, u paraqiten personalisht:

PALET KONTRAKTUESE

1. Shoqeria "INFRAKONSULT" sh.p.k e regjistruar si person juridik me NIPT L21512022F perfaqesuar nga administratori Z. Redi Struga, e biri i Bujarit, i datelindjes 22.09.1982, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin ID I209221210,

2. Shoqeria "DEA-STUDIO" sh.p.k e regjistruar nga organet tatimore me NIPT K31512110L perfaqesuar nga administrator Z. Ervin TACI, I biri i Llazar, i datelindjes 17.02.1974 lindur dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje .

OBJEKTI I KONTRATES

Palet kontraktuese lidhin kontraten e bashkepunimit te perkohshem midis tyre per marrjen pjese ne tenderat e financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me objekt:

1. «Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Durres»
2. «Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Vlore»
3. «Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), Bashkia Shkoder»

KUSHTET E KONTRATES

Shoqeria "INFRAKONSULT" sh.p.k dhe "DEA-STUDIO" sh.p.k me marreveshje vendosin perqindjet e punimeve si dhe menyren e ndarjes se fitimit si me poshte:

- Shoqeria "INFRAKONSULT" sh.p.k 65 %
- Shoqeria "DEA-STUDIO" sh.p.k 35%

Ndarja e zerave te punimeve do te ndahet sipas perqindjeve te mesiperme dhe konkretisht:



- Shoqeria "Dea studio" sh.p.k do te kryeje punimet si me poshte:
 1. Projektim arkitektonik per objekte civile-industriale-vepra arti ne infrastructure
 2. Projektim interiere
 3. Projektim paisazhi, sistemim siperfaqete gjelberta, lulishte e parqe
 4. Projektim objekte civile-industriale-turistikeprej murature e skelet betonarme deri ne 5 kat
 5. Projektim rruge urbane kryesore e rruge interurbane kryesore
 6. Projektim shtresash rrugore dhe sistemim-asfaltim
- Shoqeria "InfraKonsult"sh.p.k do te kryeje punimet si me poshte:
 1. Instalime hidrosanitare
 2. Instalime termoteknik-ventilim-kondicionim
 3. Linja e rrjeta elektrike-telefonike-radiotelefoni-citofoni-sistem alarmi—televiziv etj, per objekte civile, industriale, turistike.
 4. Projektim vepra hidraulike, ujesjelles e kanalizime urbane-rurale
 5. Furnizim me uje-kolektore shkarkimi
 6. Bazamente gjeodezike , rilevime ne te gjitha shkallet
 7. Projektim fotogrametrik-hartografik-topografik
 8. Projektim kabina elektrike ne rrjetin shperndares-linja e tensionit te ulet-te mesem

DETYRIMET E PALEVE KONTRAKTUESE

Palet kontraktuese secila sipas marreveshjes do te leshojne prokure te posacme per perfaqesimin ne tender dhe kryerjen e cdo procedure ligjore te nevojshme.

Mjetet financiare do te vendosen bashkarisht nga shoqerite e mesiperme.


Keto shoqeri mbajne pergjegjesi te plote ne te gjitha instancat per realizimin me sukses te gjitha detyrimeve kontraktore dhe perfaqesues ne tender do te jete shoqeria "Dea studio" sh.p.k

DISPOZITA TE FUNDIT

Per probleme te tjera qe do te dalin ne procesin e bashkepunimit palet do te merren vesh me lista tyre duke e bere shtese te kontrates se bashkepunimit nese kjo do te qihet e nevojshme prej tyre.

PALET KONTRAKTUESE

Shoqeria
"InfraKonsult"sh.p.k
Ing. Redi STRUGA



NOTERE
Aida A. HOZHA



Shoqeria
"DEA-STUDIO" sh.p.k
Ark. Urb. Ervin TACI





KONTRATE BASHKEPUNIMI

Sor me date 29/01/2016 (dymije gjashtembedhete), para meje AIDA HOXHA notere ne qytetin e Tiranes, me seli si me siper, u paraqiten personalisht:

PALET KONTRAKTUESE

1. Shoqeria "INFRAKONSULT" sh.p.k e regjistruar si person juridik me NIPT L21512022F perfaqesuar nga administratori Z. Redi Struga, e biri i Bujarit, i datelindjes 22.09.1982, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjofimin ID I209221210,

2. Shoqeria "DEA-STUDIO" sh.p.k e regjistruar nga organet tatimore me NIPT K31512110L perfaqesuar nga administrator Z. Ervin TACI, I biri i Llazar, i datelindjes 17.02.1974 lindur dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje .

OBJEKTI I KONTRATES

Palet kontraktuese lidhin kontraten e bashkepunimit te perkohshem midis tyre per marrjen pjese ne tenderat e financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me objekt:

1. «Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR),
Bashkia Durres»
2. «Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR),
Bashkia Vlore»
3. «Sherbime projektimi per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve (FZHR),
Bashkia Shkoder»

KUSHTET E KONTRATES

Shoqeria "INFRAKONSULT" sh.p.k dhe "DEA-STUDIO" sh.p.k me marreveshje vendore perqindjet e punimeve si dhe menyren e ndarjes se fitimit si me poshte:

- Shoqeria "INFRAKONSULT" sh.p.k 65 %
- Shoqeria "DEA-STUDIO" sh.p.k 35%

Ndarja e zerave te punimeve do te ndahet sipas perqindjeve te mesiperme dhe konkretisht:



Loti I:

Operatori ekonomik "Atelier 4" sh.p.k, me vlerë të ofertës 9,946,000 Lek pa TVSH
Operatori ekonomik "EBS" sh.p.k, me vlerë të ofertës 9,809,500 Lek pa TVSH

Loti I:

Operatori ekonomik "Atelier 4" sh.p.k, me vlerë të ofertës 2,798,000 Lek pa TVSH.
Operatori ekonomik "EBS" sh.p.k, me vlerë të ofertës 2,750,500 Lek pa TVSH.

Duke i'u referuar procedurës së lartpërmendur informojmë për:

LOTI I, operatorin ekonomik "EBS" sh.p.k, me vlerë të ofertës 9,809,500 Lek pa TVSH, me Nr.NIPT K72014002 P, me adresë, Laknas, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 9,809,500 Lek pa TVSH dhe e vlerësuar me 85.86 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme,

LOTI II, operatorin ekonomik "Atelier 4" sh.p.k, me vlerë të ofertës 2,798,000 Lek pa TVSH, me Nr.NIPT K31812012H, me adresë, S. Frashëri, P. Tid Ballkan, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 2,798,000 Lek pa TVSH, dhe e vlerësuar me 81.33 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë KESH sh.a, Blloku "Vasil Shanto", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr.9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik".

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16/05/2016.

Ankesa: Nuk ka.

FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Tirane, 03.06.2016

Për: Shoqerine "Dea Studio" sh.p.k

Procedura e prokurimit: "Sherbim Konsulence"

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), Bashkia Durrës".

Fondi limit: 41.666.666 (dyzet e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme: Nuk ka patur.



Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues:

NR	SHOQERIA
1	"TAULANT" SHPK
2	A & E ENGINEERING sh.p.k
3	Dea Studio
4	F & S
5	GJEOKONSULT & CO
6	HE & SK 11 11
7	ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS
8	KLODIODA
9	P.A.N.G.E.A. Societa Cooperativa Consortile
10	SPHAERA
11	TEC. CONSULT

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike me kryesuese shoqerine "F&S" shpk** pasi shoqeria "Invictus" shpk, pjese e ketij bashkimi, nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me pagesen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Kjo shoqeri nuk ka likuiduar detyrimet e energjisë elektrike per muajin dhjetor 2015, detyrim ky i maturuar ditën e tenderit.
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike me kryesuese shoqerine "He&Sk 11" shpk** pasi drejtuesi i propozuar i projektit nuk ka realizuar projekte te ngjashem (psh sheshe, rruge urbane, godina, etj) te zbatuar ne te pakten nje shtet te komunitetit europian apo ne nje shtet tjeter te zhvilluar.
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike me kryesuese shoqerine "Illyrian Consulting Engineers" shpk** pasi shoqeria "Illyrian Consulting Engineers" shpk dhe shoqeria "Metro Polis" shpk, pjese e ketij bashkimi, nuk plotesojne kerkesen per kualifikim lidhur me pagesen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Keto shoqeri nuk ka likuiduar detyrimet e energjisë elektrike per muajin dhjetor 2015, detyrim ky i maturuar ditën e tenderit.
- Shoqerine "Klodioda" shpk** pasi nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me pagesen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Kjo shoqeri nuk ka likuiduar detyrimet e energjisë elektrike per muajin dhjetor 2015, detyrim ky i maturuar ditën e tenderit.
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike me kryesuese shoqerine "P.A.N.G.E.A. Societa Cooperativa Consortile"** pasi shoqeria "A&I Design" shpk, pjese e ketij bashkimi, nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me pagesen e detyrimeve të maturuara të energjisë



elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Kjo shoqëri nuk ka likuiduar detyrimet e energjise elektrike per muajin nentor dhe dhjetor 2015, detyrim ky i maturuar ditën e tenderit.

6. **Bashkimi i Operatoreve Ekonomike me kryesuese shoqerine "TEC. Consult" shpk** pasi shoqëria "ACTI" shpk, pjese e ketij bashkimi, nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me pagesen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Kjo shoqëri nuk ka likuiduar detyrimet e energjise elektrike per muajin dhjetor 2015, detyrim ky i maturuar ditën e tenderit.
7. **Shoqerine "Gjeokonsult & Co" shpk** pasi drejtuesi i propozuar i projektit nuk ka realizuar projekte te ngjashem (psh sheshe, rruge urbane, godina, etj) te zbatuar ne te pakten nje shtet te komunitetit europian apo ne nje shtet tjeter te zhvilluar.
8. **Shoqerine "Sphaera" shpk** pasi nuk paraqiti propozim teknik.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqerine "Dea Studio" shpk me adrese: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla 1, kati 3, Tiranë, se oferta e paraqitur nga ana juaj me ulje 9,5% nga vlera e fondit limit te tenderit dhe e vlerësuar ne total me **92,25 pikë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit me adrese: Rruga "Sami Frashëri", Nr.10, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditesh nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2007 "Për prokurimin publik".

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.02.2016.

Ankesa: Ne datën 22.02.2016 u paraqit ankimi nga shoqëria "TEC Consult" shpk, ankimit i kthehet pergjigje ne datën 25.02.2016.

Ne datën 22.02.2016 u paraqit ankimi nga shoqëria "HE&SK 11" shpk, ankimit i kthehet pergjigje ne datën 25.02.2016.

Ne datën 26.04.2016 paraqiti ankimi shoqëria "A&E Engineering" shpk. Ankesës ju kthehet pergjigje ne datën 27.04.2016.





POLICA E SIGURIMIT TË KONTRATËS
GUARANTEE INSURANCE POLICY

0006444

		Serial/ Serial	
Ref/ Ref No.		Data / Date	08.06.2016
Për/To	FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, (Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor / Name and address of Contracting Authority)		
Në emër të/ In the name of	DEA STUDIO & INFRAKONSULT, (Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar / Name and address of the insured bidder)		
Procedurat e prokurimit (nëse zbatohet / Procurement procedures (if applicable)	SHËRBIME KONSULENCE-MARREVESHJE KUADER / (Referenca e dosjes nga Autoriteti Kontraktor / File reference according Contracting Authority)		
Përshkrim i shkurtër i kontratës/ Short description of the contract	Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), BASHKIA DURRES (Lloji i procedurës dhe objekti / Type of procedure and object)		
Publikimi (nëse zbatohet/ Publication (if applicable)	Buletini i njoftimeve publike	Nr. / No.	Data / Date
Duke ju referuar procedurës së lartpërmëndur, dhe me kusht që: Referring to the above procedure and provided that:		DEA STUDIO & INFRAKONSULT (Emri i ofertuesit të përcaktuar fitues / Name of the winning bidder)	
ti jetë akorduar kontrata, ne vërtetojmë se: to be accorded the contract, we certify that:		DEA STUDIO & INFRAKONSULT (Emri i ofertuesit të përcaktuar fitues / Name of the winning bidder)	
Ka depozituar, pranë Shoqërisë së Sigurimit "ANSIG" sh.a. deposited in the name of "ANSIG" sh.a. Insurance Company			
Vlerën prej: Value of:	4,525,000.00 Lekë	Katër Milion e Pesë Qindë e Njëzetë e Pesë Mijë (monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra / currency and value both in words and figures)	
Si kusht për sigurimin e zbatimit të kontratës, që do të nënshkruhet me: As a condition for implementation of the contract signed with:	FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (Emri i Autoritetit Kontraktor / Name of the Contracting Authority)		
Marrim përsipër të transferojmë në llogari: We are liable to transfer at the account of:	FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (Emri i Autoritetit Kontraktor / Name of the Contracting Authority)		
Vlerën e siguruar, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar më shpjegime me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e kushteve të Kontratës. / The insured value within 15 (fifteen) days from your first written request, without requiring any explanation, in case of unfulfilled terms of the contract.			
Ky sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës / This insurance is valid up to the full implementation of the contract			
Nga Data / From	08.06.2016	Deri më / Up to	Deri në realizimin e plotë të kontratës
Lëshuar në / Issued to	Tiranë	Data Lëshimit/ Issued Date	08.06.2016

Jam dakort me kushtet e përgjithshme bashkëngjitur kësaj pollice / I agree with the general conditions attached to this policy.

DEA STUDIO & INFRAKONSULT Insured

(emër, mbiemër, firmë)

DEGA (Brand) AGJENTI (Agent)

(emër, mbiemër, firmë, vulë)



1. Termat e references per projektet e kerkuara per sherbim konsulence ne marreveshjen kuader FSHZH - konsulent DEA Studio shpk per projektet:

1. Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i shkolles se Muzikes "Jan Kukuzeli", Durres
2. Shetitorja bregdetare pergjate plazhit tek "Shkemb i Kavajes" si edhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) - "Shkembin e Kavajes"
3. Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Qendres Kulturore te Femijeve Durres
4. Rindertimi i shkolles "Jusuf Puka" Durres
5. Itinerar i ri turistik ne zonen historike te qytetit te Durresit (Amfiteater - Fari)
6. Porta e Jallise - Hamami

1. Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i shkolles se Muzikes "Jan Kukuzeli", Durres


Bashkia Durres koncepton nderhyrjen ne kete shkolle si nje mundesi per permiresimin e kushteve te pregatitjes se brezave te ardhshem te artisteve, por njekohesisht edhe si nje potencial per shnderrimin njekohesisht te saj ne nje potencial aktivitetesh kulturore dhe artistike edhe per qytetin. Shkolla ka nevojat dhe problemikat e saj te mbartura nga koha ne lidhje me degradimin fizik te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, por njekohesisht edhe mosperputhje me standartet bashkohore te shkollave te tilla analoge ne vendet me te perparuara ne bote. Gjithashtu, nderhyrja duhet te marre parasysh standartet Europiane per ruajtjen e energjise, per personat me aftesi te kufizuar dhe per mbrojtjen kundra zjarrit. Fushat e sportit, salla e koncerteve, apo edhe ateliere e piktures duhet te konceptohen me potencial per t'u shfrytezuar edhe gjate oreve te mbasdites nga banoret e qytetit.

Volumi kryesor i objektit funksionon ne kushte relativisht te mira aktualisth, por ka rifinitura te vjeteruara dhe mungese te infrastruktures se ngrohjes se pergjithshme. Kati perdhe eshte keq i ajrosur dhe mbart ne vete nje ere te rende, gati mbytese ne ambjentet e perbashketa (holl dhe korridore). Klasat e ushtrimit te solisteve jane te perziera me klasat e lendeve te pergjithshme. Kjo sjell ndotje akustike dhe mungese perqendrimi te nxenesve per shkak te mbivendosjes se zhurmave (muzikes nga vegla te ndryshme muzikore). Gjithashtu, edhe vete nxenesit qe studiojne si soliste ndejne shqetesimin e interferimit me klasat ngjitur tyre dhe humbje te perqendrimit maksimal, qe kerkon vegla muzikore. Ne keto kushte lind e nevojshme nje rishikim funksional i pozicionimit te ambienteve te kultures se pergjithshme ne lidhje me klasat e solisteve, por edhe mbrojte akustike e ambientit nga ambjenti. Volumet e shtuara volumit kryesor pas viteve '90 qendrojne si trupa te huaj me volumin baze. Ato jane te shkeputura ne lidhjen e drejtperdrejte funksionale dhe realizojne ne menyre te cunguar funksionet e tyre perkatese. Lidhja e ambienteve ekzistuese te klasave te kultures se pergjithshme me ateliere e arteve pamore, skulptures dhe piktures behet ne kushte aspak normale, perkundrazi ne kushte te veshtira dhe qe duhet te rishikohet nga projektuesi. Ne vazhdimin e volumit te atelieve te arteve pamore eshte e pozicionuar palestra e shkolles me dimensione 7x15m dhe lartesi 5m. Kjo palester nuk



ploteson as edhe 1 standart minimal per t'u quajtur e tille ne nje shkolle normale ku gjithmone e me teper po shikohet shendeti fizik si edhe shendet mendor. Ne vazhdim te volumit te palestres gjendet salla e koncerteve e cila eshte totalisht e shkeputur nga nderlidhja funksionale me volumin ekzistues te shkolles. Edhe per kete arsye ajo shfrytezohet teper pak per destinacionin teper te rendesishem qe duhet te kishte. Gjithashtu, pjese e ketyre shtesave te njepasnjeshme volumore te bera ne kohe te ndryshme te paprogramuara fillimisht dhe pothuaj te pa integruara me njera-tjetren, jane edhe 1 salle provimesh per muziken me 30 vende uljeje dhe 1 bibliotek me rreth 12 m2, qe ne fakt me teper eshte nje magazinim librash. Oborri i shkolles eshte nje siperfaqe e hapur, por e shfrytezuar keq pasi shume siperfaqe te saj jane jo funksionale. Kjo siperfaqe permban 2 fusha sportive, njera basketbolli dhe tjetra volejbolli dhe ne perimetrin e saj Lindor nje siperfaqe te tere te pushtuar nga nje vendstrehim ushtarak qe dikur sherbente ne kushtet e luftes psikologjike te "ftohte" per strehimin e qytetareve ne kushtet e luftes. Te gjitha keto siperfaqe duhet te rishikohen sin je unitet hapësirash dhe mundesi shfrytezimi maksimal te tyre ne funksion te kesaj detyre projektimi me kerkesat e saj specifike.


VENDNDODHJA



PAMJE TE GJENDJES EKZISTUESE



PROBLEME FUNKSIONALE DHE KONSTRUKTIVE



1. Mungesa e ambjenteve mesimore


2. Mungesa e hapësirave rekreative

3. Probleme të zonimit funksional të ambjenteve të brendshme

4. Mangësi e sigurisë për rastet e emergjencës



ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE PROBLEMATIKAT E SHKOLLES




Projekti duhet te arrije sa me poshte:

1. Programin funksional sipas organigrames dhe siperfaqeve funksionale te kerkuara.
2. Rikonceptimin e hapësires se hyrjes se shkollës si nje hapësire publike ne funksion te zones se banimit, por edhe si parahyrja per ne shkollë.
3. Shfrytezimin e siperfaqes ekzistuese te shkollës dhe pershtatjen e saj ne nje skeme teresore funksionale, me te gjitha kerkesat per shtesa funksionesh si edhe permiresimin e atyre ekzistuese.
4. Rishikimin e ambienteve ekzistuese te mbyllura sportive te shkollës (palestra), qe te jete me parametra te standarteve Europiane (pers shkollat) per fushe basketbolli dhe volejbolli. Te parshikohen gjithashtu ambient magazinimi materialesh rreth 40 m², 2 dhoma zhveshjesh meshkuj femra, tualete dhe dushe.
5. Te rishikohen edhe ambientet e hapura te jashtme ne funksion te aktivitetit sportiv kompleks.
6. Biblioteke e re per shkollën me siperfaqe rreth 120m²

7. Te gjykohet nga pikepamja funksionale, por edhe e kushteve ekzistuese fizike ndertimore dhe strukturale gjendja e salles aktuale te koncerteve (salla ka kohe te gjate ne prezence te jageshures se ardhur nga tarraca e objektit si edhe nga fuga ekzistuese

Shkolla "9 vjeçare artistike "Jan Kukuzeli"		
Gjendja ekzistuese		
Kapaciteti 380 nxenes		
Ambjenti	Numri	Siperfaqja
Siperfaqe trualli		5565 m2
Siperfaqe ndertimi ne baze		1127 m2
Siperfaqe e ndertuar		2443 m2
Fusha sportive basketaball	2	817 m2
Klasa te pergjithshme Kati perdhe	7	(27-48 m2) 238 m2
Klasa te pergjithshme Kati I pare	7	(27-39 m2) 247 m2
Klasa te pergjithshme Kati I dyte	3	(29-39 m2) 104 m2
Klasa te pergjithshme (Total)	17	589 m2
Klasa muzike kati perdhe	4	49 m2
Klasa muzike kati I pare	4	49 m2
Klasa muzike kati I dyte	18	215 m2
Klasa muzike (Total)	26	313 m2
Klasa pikturë	5	136 m2
Klase informatike	1	40 m2
Salle provimi	1	49 m2
Tualete (vetem kati perdhe)	6	46 m2
Palestra	1	133 m2
Salle koncertesh	1	(180 vende) 246 m2
Ambjente te nevojshme per t'u shtuar		
Klasa muzike	8	(6-8 m2) 48-64 m2
Klasa te pergjithshme	3	(65-68 m2) 195-204 m2
Klasa pikturë	2	(85 m2/klasa) 170 m2
Biblioteke	1	110 m2
Salle mesuesish	1	40 m2
Sekretari	1	25 m2
Dhome per sanitaret	1	12 m2
Tualete (shtese ne dy kate)	18	86 m2
Palestra 2K (volum I ri)	1	844 m2
Salle koncertesh (volum I ri) 204 vende	1	855 m2
Fushe sportive e re	1	544 m2
Totali ambjente per t'u shtuar		2954 m2

me volumin e palestres) nqs ajo duhet ruajtur apo duhet parashikuar nje e re ne volumet e reja te ndertimit. Ne qofte se projektuesi gjykon nje salle te re ajo duhet te jete te pakten me nje kapacitet prej 200 spektatoresh, te jete sa me fleksibile per te realizuar shfaqje te ndryshme, sollistesh, duetesh, orkestre me te gjere, koresh



muzikore, shfaqje teatrale, ekspozita te artit pamor (skulptur, piktur, instalacione, etj), organizime festive te shkolles dhe me gjere. Kjo salle te ishte fleksibile edhe per shfrytezim gjate oreve te mbasdites apo edhe ne fundjave per aktivitete kuturore artistike te qytetit.

8. Riberjen e te gjitha rrafshetave te mureve te brendshme dhe te jashtme per volumin ekzistues, qe do te pershtatet ne skemen e re funksionale.
9. Projekti duhet te parashikojë marrjen e masave teknike per te arritur koeficiente sipas normave EU per shkembimin e energjise. Per muret perimetrare (te jashtme) $U < 0.6 \text{ W/m}^2$ dhe per vetratat, profili i vetrates $U_f < 1.5 \text{ W/m}^2$ dhe xhamat $U_w < 1.4 \text{ W/m}^2$. Projektuesi duhet te marre parasysh, qe ne projektin e zbatimit te parashikojë materiale dhe sisteme, qe jane te pajisura me çertifikata Europiane per energjine dhe deklaratat e konformitetit. Arritja e ketij koeficienti mund te realizohet me aplikimin e fasadave termike, pra fasada te ventiluara, kapota termike, perdorimin e materialeve termoizoluese, etj. Ndersa per vetratat e jashtme duhet, qe projekti te specifikojë llojin e vetrates dhe detajin e profilit, qe mundeson arritjen e koeficientit te mesiperm.
10. Projekti duhet te marre parasysh arritjen e parametrave te pranueshem EU per ndotjen akustike. Koeficienti per muret e jashtme dhe vetratat duhet te jete jo me pak se 45db.
11. Projekti duhet te marre parasysh edhe marrjen e masave per mbrojtjen akustike ndermjet sallave te ushtrimit te solistev ne menyre, qe ato te mos kene interferime me njera tjetren.
12. Projekti duhet te realizojë te gjitha kriteret kombetare dhe EU per personat me aftesi te kufizuar.
13. Projekti duhet te respektojë normat kombetare dhe Europiane per mbrojtjen kundra zjarrit persa i perket rrugeve te shpetimit, dyerve te zjarrit qe izolojne hapesirat nga tymi, koeficientet e zjarr durueshmerise se dyerve dhe mureve per EI = 60 min zjarr, detajet e hapjes antipantik, etj. Sistemet e perdorura duhet te jene te pajisura me çertifikatat perkatese EU per mbrojtjen kundra zjarrit.
14. Impiantet mekanike ne godine duhet te perzgjidhen ne baze te kerkesave me te larta te kursimit te energjise, duke perdorur tipologji te pershtatshme per ambientet dhe destinacionin e tyre. Ne rastin e pergjithshem do te realizohet sistemi i ngrohjes per ambientet mesimore-didaktike. Ajrimi do te mundesohet te jete natyral nepermjet hapjes se dritareve. Projektuesi te shohe mundesine qe te realizohet ne maksimumin e mundshem ajrimi horizontal dhe vertikal i holleve-korridoreve, por edhe i klasave qe gjate pushimeve kur hapen dyert te jete i mundur ajrimi horizontal. Palestra nuk ka nevojë per ngrohje, por projektuesi duhet te mundesoje nepermjet rrugeve te projektimit pasiv te arrije maksimumin per te realizuar ajrimin horizontal dhe vertikal maksimal te hapesires se saj si edhe hijezimin. Projektuesi duhet te realizojë ajrim- ngrohje ftohje kondicionimi dhe furnizimi me ajer te fresket per sallën e

shfaqjeve, duke siguruar temperaturat Dimer/Vere $20^{\circ}\text{C}/25^{\circ}\text{C} \pm 1^{\circ}\text{C}$, lagështia $30\%/50\% \pm 5\%$ si dhe ajer të freskët deri në $50\text{m}^3/\text{h}$ për person.

15. Impianti i mbrojtjes ndaj zjarrit, projektimi, instalimi dhe venia në kushte pune të rrjetit hidraulik nën presion që duhet të furnizojë me ujë hidrante, naspo, apo sprinkler duhet të jenë konform me normes europiane UNI9490 dhe UNI 10779, nga niveli i ngarkesës së zjarrit të parashikuar (i limituar, i moderuar apo rrites) merren në konsideratë tre zona dhe klasifikohen në baze të normativës UNI9489 si Zona e Klasit A, Zona e Klasit B dhe Zona e Klasit C. Për objektin dhe karakteristikat e tij të shfrytëzimit impianti duhet projektuar me hidrante statik të normës UNI45, dhe bombola me pluhur.
16. Impianti i furnizimit me ujë të ftohtë sanitar duhet projektuar sipas kërkesave me të larta, duhet të garantojë një rezervë ujore për rastet e mungesës së furnizimit nga rrjeti i qytetit dhe duhet siguruar një sasi uji 10Lit./Person . Prodhuimi i ujit të ngrohtë sanitar duhet të realizohet me pompe nxehtësie për të marrë ujin e ngrohtë sanitar me minimumine konsumit energjistik. Akumulimi i ujit të ngrohtë duhet të ruajë ujin me temperaturë 65°C për të mos lejuar krijimin e baktereve dhe legjionelës. Duhet të ketë edhe një rezistencë elektrike e cila do të jetë e kontrolluar manualisht. Linja e riqarkullimit duhet të mbajë linjat me ujë të ngrohtë sanitar dhe programohet, që në një orar të ditës të bejë edhe ngordhjen e mikroorganizmave dhe legjionelës. Pajset hidrosanitare duhet të jenë të tipit të varur (sospeso) për të maksimalizuar higjienën në nyjet sanitare të objektit.
17. Projekti elektrik duhet të marrë parasysh aplikimin e teknologjive me të përparura për të arritur konsum minimal të energjisë, veçanërisht për ndriçimin, sistemin e kontrollit të hyrjes (access control-it), sistemi i video-vezhimit, impiantin data dhe telefoni, dhe sistemin rrufeprites dhe tokezues.
18. Projektuesi duhet të marrë parasysh, që në projektin e zbatimit të parashikojë materiale dhe sisteme, që janë të pajisura me çertifikata Europiane të sistemeve dhe deklarata konformiteti.
19. Projekti në kompleksitetin e tij duhet të marrë parasysh përmirësimin e shfaqjes së jashtme të objektit për të krijuar një identitet të mirefillte, që do ta personifikonte atë si një objekt me identitet të mirefillte pjesëmarrës protagonist në arkitekturë dhe një funksion artistik për qytetin.

Me poshtë disa nga të dhënat baze të funksioneve në gjendjen ekzistuese dhe nevojat kryesore për shtesa funksionale në përputhje me përmirësimin e standarteve.



1. LISTA E FLETEVE TE PROJEKTEVE QE DUHEN PARAQITUR

Projektuesi ne fazen e projekt-zbatimit duhet te paraqese sa me poshte:

- Plani i pergjithshem i pozicionimit te objektit ne lidhje me qytetin
- Planvendosja e objektit sh 1:500
- Plani i sistemimit 1:200
- Plani i katit perdhe 1:100
- Plani i katit te pare 1:100
- Plani i katit te dyle 1:100
- Plani i mbuleses dhe kullimit te ujerave 1:100
- Prerjet gjatesore (te pakten nje) 1:100
- Prerja terthore (te pakten nje) 1:100
- Fasadat (minimalisht 4) 1:100
- Detaje te mbuleses se objektit
- Detaje te vetratave
- Detaje te dyerve te brendshme
- Detaje te mureve te jashtme
- Detaje te mureve te brendshme ndarese.
- Detaje te sistemimeve te jashtme
- Detaje te hidroizolimeve
- Detaje te shkarkimit te ujerave
- Projekti konstruktiv
- Projekti mekanik
- Projekti hidrosanitar
- Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit
- Projekti elektrik
- Projekti i hyrjes se kontrolluar (access control)
- Projektin per sistemin i video-vezhgimit,
- Projektin per implantin data dhe telefoni,
- Projekti i sistemit rufeprites dhe tokezues.
- Plani i organizimit te punimeve te objektit
- Plani i piketimit
- Grafiku i punimeve
- Relacioni teknik i projektit
- Specifikimet teknike te projektit
- Preventivi i punimeve te parashikuara ne projekt




2. Shetitorja bregdetare pergjate plazhit tek "Shkemi i Kavajes" si edhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) – "Shkembini e Kavajes"

Bashkia Durres ka hartuar nje projekt te "Rikulifikimit te zones midis kanalit te ujerave te larta ne Jug te Shtepise se Pushimit te Ushtrise, rruges dytesore ne krah te superstrades Durres-Kavaje, kufirin ndares dhe ne Perendim vijen kufizuese me plazhin.", i cili ka qene pjese e aplikimit per kerkesa bashkefinansimi me Fondin e Zhvillimit Rajonal. Nderkohe Bashkia Durres pa mbivendosur projektet dhe financimet ka menduar te hartoje nje projekt tjetër qe merr parasysh kopletimin e projektit te cilesuar me siper me konturimin e tij ne perendim me nje shetitore bregdetare per kete zone dhe njekohesisht lidhjen e saj dhe zones me "Shkembini e Kavajes" si nje element natyror dhe me potencail per te qene atraksion turistik per zonen. Kjo nderhyrje do te perbente evidentimin e nje "shenje natyrore" (landmark-u natyror) kombetar te vecante ne infrastrukturen urbane, por qe sjellin impakt te drejtperdrejte te prekshem ne zhvillimin e ekonomise dhe turizmit. Ky propozim mund t'i referohet edhe studimit te fizibilitetit te hartuar nga nje shoqeri konsulente e kontraktuar nga PNUD ne vitin 2012 (United Nations-Development Programe - Albania "Sustainable Tourism Development Feasibility Study for the Durres Plepa – Perroi i Agait Area") ku sygjerohet funksionalizimi dhe nderlidhja e gjithë zhvillimeve ndertimore me shetitore bregdetare funksionale, shfrytezimi i asetëve natyrore si atraksione turistike (si rasti i "Shkembini te Kavajes") dhe nderlidhja ndermjet tyre.

1. Megjithese hapësira funksionale ndermjet godinave dhe vijes bregdetare eshte shume e ngushte ne kete perimenter, shetitorja pergjate bregut eshte e domosdoshme per te mundesuar pervec aktivitetit funksional-fizik te saj edhe nderlidhjen fizike te sherbimeve dhe funksioneve te tjera, sportive, lulishte, etj pergjate saj. Seksioni i saj nuk mund te jete shume i gjere, por potencialisht ai mund te zgjerohet ne hapësirat, qe krijohen nga distancat ndermjet objekteve te ndertuara dhe ato mund te interpretohen si sheshe funksionale per grumbullimet kembesore, mini-lulishte, mini-kende sportive, etj. Ky projekt duhet te nderlidhet nga konsulentit me projektin hartuar nga bashkia durres per hapësirat e brendshme funksionale te kesaj zone.
2. "Shkemi i Kavajes" ka qene historikisht nje pike referimi per te gjithë perimetrin e bregut te detit "Plepa"-Golem-Kavaje, duke qene mbi te gjitha nje element i spikatur unikal natyror. Historikisht ai ka qene i perceptuar vizualisht si monument natyror nga rruga kombetare, qe i kalon gati tangent ne Perendim te tij. Ai ka qene ne fakt "papakshem" fizikisht pasi ka qene zone ushtarake dhe si e tille nuk mund te vizitohet as ne perimetrin e poshtem te tij dhe as ne ate te siperm. Pas viteve '90 e humbi statusin e zones ushtarake, duke mundesuar me ne fund edhe "prekjen" e tij nga afer. Fatmiresisht ne vitet e fundit ku kontrolli mbi ndertimet informale ka qene



pothuaj inekzistent, ky element natyror i shpetoi dhunimit te tij. Ndertime te ketij karakteri jane bere, por ne nje distance te caktuar, qe nuk ja cenojne vizualisht siluetin. Ne vitin 2002 "Shkembiti Kavajes" i eshte dhene statusi monument natyror i mbrojtur. Ne projekt-studimin e PNUD-it te vitit 2012 United Nations Development Programe - Albania "Sustainable Tourism Development Feasibility Study for the Durres Plepa – Perroi i Agat Area", Shkembiti Kavajes permendet pikerisht si nje element natyror i cili mund te sherbeje njekohesisht edhe si nje atraksion turistik dhe sygjeron edhe menyren elegante te nderhyrjes, qe do le mund t'i behej potencialisht ne te ardhmen. Nder teperpermendet (shih bashkangjitur materialit) lidhja me zonen e plazhit nepermjet nje lidhjeje te tipit ure, qe do te mundesonte kalimin e autostrades per kembesoret dhe bicikletat, shfrytezimin i itinerareve ekzistuese natyrore per te arritur kuoten e tij me te larte 105m mbi nivelin e delit dhe per ta shfrytezuar ate si pike panoramike per turistet, Gjithashtu, sygjerohet vendosja e elementeve mbrojtjes perimetral, qe sigurojne rrezikshmerine e afrimit te njerezve ne perimetrin e tij te thepisur.







Foto te gjendjes ekzistuese te perimetrit bregdetar te ndertuar, potenciali i perimetrit te shetitores





Itinerari kembesor i "Shkembit te Kavajes"

DETYRAT PËR T'U KRYER

Shetitorja bregdetare pergjate plazhit tek "Shkemb i Kavajes" si edhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) – "Shkembin e Kavajes" përfshin në trajtimin e tij sa me poshte:

- 1. Perimetrin e shetitores bregdetare nga ish-shtepia e pushimit te ushtarakeve deri ne kufirin me verior te shetitores ekzistuese te financuar nga Bashkia Kavaje**
 - Dizenjimi urban dhe pejsazhistik
 - Projektimi i nje gjurme te dedikuar per kembesore dhe per grupet turistike. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash.
 - Trajtimin e fasadave te banesave që ballafaqohen me hapesirat publike, meremetim, lysterje (nqs eshte e nevojshme).
- 2. Sheshe funksionale pergjate perimetrin te shetitores nga ish-shtepia e pushimit te ushtarakeve deri ne kufirin me verior te shetitores ekzistuese te financuar nga Bashkia Kavaje**
 - Identifikimi i hapësirave ekzistuese potenciale per t'u kthyer ne hapësira dhe sheshe urbane funksionale
 - Dizenjimi urban
 - Hapësira te dedikuara funksionale per aktivitete te ndryshme qe kane lidhje me funksionet e sherbimit te zones se banuar, por edhe per turistet e vizoret vendas e te huaj, si hapësira sportive, tregje shitje fruta-perime, lulishte-parqe, parkim makinash, parkim biçikletash, etj.
 - Trajtimin e fasadave te banesave që ballafaqohen me hapësirat publike, meremetim, lysterje (nqs eshte e nevojshme).
- 3. Gjurma (rrugica kembesore) nga ura ekzistuese e lidhjes se zones se plazhit me zonen pertej hekurudhes deri ne destinacionin e "Shkembit te Kavajes" si edhe rrugica ekzistuese kembesore, qe te nxjerrin tek rruga kryesore automobilistike ne Lindje (ne kuoten me te sipërme te kodres).**
 - Ndjekja e gjurmes rrugore ekzistuese, permiresimi strukturor i saj dhe krijimi i nje shtegu te dedikuar per kembesor.
 - Ndjekja e gjurmes ekzistuese kembesore pas perfundimit te rruges automobilistike
 - Dizenjimin urban te gjurmes se re me shtrime te kujdesshme te dedikuara per kembesore per grupet turistike me materiale me baza sa me te lidhura me mjedisin. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash.



Gjurma e propozuar e rruges

1. Duke perdorur si baze gjurmen e rruges ekzistuese (ne rastin e rehabilitimeve dhe rindertimeve), profilin dhe llojin e terrenit te nxjerre ngaurvejimet topografike, konsulenti duhet te pergatise nje projekt final, duke perfshire intersektimet, afersine me rruge te tjera dhe zonat urbane. Ne realizimin e ketij projekti, pritet qe Kontraktori te perdore programe kompjuterike lehtesuese ne projektimin e rruges. Duhet bere gjithashtu ri-projektimi i gjurmes ne menyre, qe te lehtesoje kthesat e forta, per sigurimin e shikueshmerise etj. Elementet e profilit terthor duhet te projektohen ne perputhje me udhezimet e projektimit te rrugeve. Te shihet mundesia e vecimit qartazi te gjurmes se levizjes kembesore nga gjurma e levizjes automobilistike. Brenda mundesive ne frakte te caktuara rrugore te evidentohet vizualisht dhe funksionalisht edhe gjurma e levizjes me biciklete.
2. Vizatimet per planimetrite e kryqezimeve, prerjet ne zonat urbane dhe karakteristika te tjera te rendesishme do te pergatiten ne nje shkalle te pershtatshme me te madhe me instalimet e nevojshme dhe informacionin e drenazhit. Per zonat urbane duhet te jepen detajet e sherbimeve, drenazhimi, zonat e parkimit, trotualet, ndricimi, etj. Duhet te realizohen vizatimet standarte per shenjat e trafikut, vijezimet dhe karakteristika te tjera te kontrollit dhe sigurise se trafikut, puseta per fibra optike, struktura drenazhi te vogla dhe elemente te tjere te vegjel.
3. Shtresat - Projektimi i paketes se shtresave duhet te pergatitet bazuar ne: • Standartet e projektimit dhe ngarkesat e trafikut, percaktuar nga konsulenti; • Ne gjetjet e investigimit gjeoteknik dhe gjendjes se rruges te vleresuara nga konsulenti, te ndermarra sipas paragrafit 2.4, integruar me te dhenat e disponueshme nga databaza e shtetit (aty ku eshte e mundur); dhe • Deflektori i rruges
4. Sistemi i Drenazhimit dhe Punimet Mbrojtese
5. Sistemi gjatesor i drenazhimit i integruar me sistemin terthor te tij do te zbatohet ne te gjitha gjatesine e projektit. Projektimi i drenazhit duhet te perfshije integrimin e drenazhit te rruges me sisteme te tjera drenaxhi (nese ka) si dhe projektimin e drenazhit per kryqezime.
6. Te tregohet kujdes ne zgjidhjet teknike te drenazheve gjatesore neper kryqezimet e rruges. Per seksione te rruges me karakteristika specifike duhet te parashikohen sisteme drenazhimi te posaçme.

Punime bio-inxhinjerieke

1. Do te vleresohen teresisht nga konsulenti kerkesat per punime mbrojtese per te siguruar qendrueshmerine e skarpatave dhe rezistencen e dheut ndaj erozionit pergjate ndonje terreni me potencial rreshqites dhe shtresave te dheut te pakonsoliduara, pergjate rruges dhe duhet te behen parashikime te sakta per veprat bio - inxhinjerieke.
2. Punimet bio-inxhinjerieke duhet te zgjidhen sipas tipit te bimesise, vendodhjes dhe detajeve te tjera, ne specifikime dhe vizatime. Punimet mbrojtese do te perfshijne

gjithashtu mbrojtjen e rrjedhes se sipërme/poshtme ujore qe potencialisht mund te pershkoje rrugen.

Strukturat

1. Duhet pergatitur projekte te detajuara te strukturave. Projektet do te hartohen per te maksimizuar perdorimin e komponenteve standarde dhe projekteve te strukturave. Ne veçanti per struktura te vogla; tombino rrethore apo box, struktura te mbikalimeve apo nenkalimeve, etj. me alternativa te preferuara te parafabrikuara.
2. Nenstrukturat do te dimensionohen mbi bazen e investigimeve te detajuara ne terren, duke reflektuar praktiken me te mire nderkombetare. Ne zgjedhjen e tipit te themeleve Kontraktori duhet te marre parasysh gjithashtu kohen e kerkuar per ndertimin e aleternativave, dhe ti japi perparesi atyre, qe shkurtojne kohen e ndertimit. Projektimi i urave duhet te marre parasysh kerkesen per trotuar per kembesoret.
3. Llogaritjet duhet te kryhen ne perputhje me praktikat e pranueshme nderkombetare (si psh. Eurocodet siç jepet ne Sek 4 te draftit ARDM5.1) dhe do te perdore teknikat kompjuterike. Sizmika dhe te dhena te tjera do te merren parasysh sipas nevojës.

Mjetet e Sigurise Rrugore, Kontrollit te Trafikut dhe Facilitete te Tjera

1. Rekomandimet per siguri ne rruge do te integrohen ne projektin inxhinierik ne formen e planimetrive te permiresuara te kryqezimeve, arranzhimin e kufizueseve te trafikut per uljen e shpejtesise se automjeteve, facilitetet per kembesoret, vijejimi i rruges i permiresuar dhe instalimi i shenjave te trafikut, delineatoret e rruges, spotet fluorishente dhe çdo zbutes tjeter trafiku dhe/ose mjete te sigurise rrugore te menuara te nevojshme nga Kontraktori.
2. Planimetrit e vijizimit te rruges dhe shenjave te trafikut do te pergatiten per levizjen e sigurt dhe efikase te trafikut. Te dyja duhet te bazohen ne praktikat nderkombetare per rruge te tipit te tille, rregulluar sipas diskutimeve me Autoritetin Kontraktor te permbushi Kodin e Rrugeve Shqiptare aktual: "RREGULLORE PER ZBATIMIN E KODIT RRUGOR" (zbatimi i kodit rrugor) Vol. II "STANDARTET E SINJALIZIMIT RRUGOR" dhe draft Manualit te Projektimit te Rrugeve per Shqiperine ARDM6.
3. Duhet te pergatiten projektet e ndricimit te rruges per seksionet brenda zones urbane dhe zona te tjera ku eshte i nevojshem ndricimi.

2. Projekt-Zbatimi

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projektit, desë nga Autoriteti Kontraktues, Kontraktori do të hartojë projektin e zbatimit, i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm per zbatim.

Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

1. Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj të zbatimit të punimeve. Studimi duhet te permbaje informacion per ujrat sipërfaqesore dhe nentokesore dhe strukturat e drenazheve.



2. Per te kryer survejimin topografik, Kontraktori do te perdore Total Station, GPS ose pajisje te ngjashme me te ne teknike dhe procedura, te cilat zhvillohen ne kompjuter, ne baze te modelimit topografik te terrenit.

Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik dhe Investigimit te Materialeve

1. Kontraktori në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt-idesë pranë Autoritetit Kontraktues.
2. Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:
 - a. tekstin e raportit, parametrat gjeoteknike të projektimit;
 - b. materialin grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të veçante te shpimeve;
 - c. cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues (nese ka);
 - d. konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

Investigimet Hidrologjike dhe Hidraulike

1. Kontraktori duhet te beje nje studim me te dhena shtese te vlefshme dhe te nevojshme mbi hartën topografike, kohezgjatjes se rreshjeve, statistikave te tyre, karakteristikave te dheut bimesise etj, ne menyre qe te kete akses ne zonen ujembledhese si dhe parametrat hidraulike per te gjitha strukturat dhe tombinot ekzistuese dhe te reja qe do te parashikohen ne projekt.
2. Kontraktori do te mbledhe informacion mbi nivelet e permytjes, kuoten e ulet te ujrave, shpejtesine e shkarkimit etj, nga te dhena te meparshme te disponueshme, nga raporte investigimi ekzistues dhe shenja te dukshme ne terren.

Investigimi i Sherbimeve Publike

1. Kontraktori duhet te mbledhe detaje te çdo parametri fizik pergjate gjurmes se rruges, linjat e shtyllat elektrike e te telefonise, sherbimet nentokesore, vendodhjet e pusetave, si dhe tipe te tjera sherbimesh si p.sh: fibra optike, pusetat e shiut, ujrave te zeza, tubacione te gazit/naftes ne menyren e duhur dhe qe pritet te preken nga ndertimi i rruges. Informacioni i mbledhur duhet te paraqitet ne nje plan zhvendosjesh ne menyre qe zgjatja e afatit te dorezimit dhe rivendosja e strukturave dhe sherbimeve te mund te vleresohen ne menyre te pershtatshme. Plane zhvendosjeje te ndara per çdo sherbim (energji, telefon, uje etj.) te perfshire, duhet te përgatiten per te lehtësuar kështu koordinimin me agjensite ne ngarkim.
2. Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit
3. Mbas përpunimit të projektit dhe hartimit të projektit përfundimtar të zbatimit, konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet t'i referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje konsulenti.

4. Konsulenti do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes së materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre.
5. Në këtë fazë gjithashtu, kontraktori do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të spostimeve të ndryshme elektrofonike apo të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.
6. Kontraktori do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra gjatë zbatimit të punimeve për sigurinë në punë.

Volumet e punës dhe Preventivi

1. Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve, që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).
2. Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë çmimet njësi të Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit, në fuqi. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar, duhet të shoqërohen me analizën e llogaritjes së çmimit.
3. Preventivi do të shoqërohet edhe me dhe grafikun e punimeve.
4. Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit
5. Raporti i projektit përfundimtar të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mëposhtëm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

Raporti duhet të përmbajë:

Raportin teknik të projektimit arkitektonik.

Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.), si dhe masat inxhinierike, që janë parashikuar të merren, si siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit etj. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.

Preventivi i plotë.

Vizatimet përfundimtare

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të përgatisë e dorëzojë vizatimet e mëposhtme si pjesë bazë e dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve. Vizatimet përfundimtare të projekt zbatimit duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhurnuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)

Vizatimet



Kontraktori në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të përgatise e dorezoje vizatimet e mëposhtme, si pjesë bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Plani i Përgjithshëm i pozicionimit të zonës së nderhyrjes në lidhje me qytetin 1:25000 (1:10000)
- Plani i Përgjithshëm i nderhyrjes Sh 1:1000/2000
- Planimetri të zmadhuara në shkallë pjesë të planit teresor të identifikuar për pozicionimin në skemën e përgjithshme sh 1:100/200
- Planimetri e rrjeteve kryesor dhe shpërndaresh të ujit të pijshëm në shkallë 1:1000
- Planimetri e rrjeteve kryesor të kanalizimeve të ujerave të zeza në shkallë 1:1000
- Planimetri e rrjeteve kryesor dhe shpërndaresh të ujit të pijshëm në shkallë 1:1000
- Planvendosje dhe prerje të kaptazheve të ujit në shkallë 1:500
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1:100
- Profila tërthor SH 1:20
- Detaje të ndryshme (puseta ajrimi, shkarkimi, kontrolli, etj) SH 1:25; 1:50
- Harta e rievimit topografik SH 1:1000
- Harta hidrologjike SH 1:5 000
- Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200
- Grafiku i punimeve

Nqs nderhyrja urbane përfshin në konceptimin e saj edhe nderhyrje në fasadat ekzistuese duhet të paraqiten gjithashtu:

- Foto të fasadave ekzistuese
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e propozuara Shk.1:100

Grafiku i punimeve

Raporti i vleresimit të ndikimit në mjedis



Projekt zbatimi do të përmbajë edhe Raportin e vleresimit të ndikimit në mjedis (VNM), hartuar në përputhje me kërkesat e renditura në Aneksin 6.



Nderlidhja e asetit natyror "Shkëmbit të Kavajës" me shetitoren e bregut do të bëjë me interesante gjithë këtë zonë për turistët vendas dhe të huaj. Lidhja fizike e tyre mund të realizohet nepermjet një ure ekzistuese kembësore, ndërkohë që në të ardhmen mund të realizohet një ure me dinjitoze. Gjithashtu, projekti duhet të parashikojë që në të ardhmen pjesë e nderhyrjes mund të jete edhe një dalje në det me skoliere për kembësoret në aksin e ures për ta bërë edhe me intriguese interaksionin e të gjithë elementeve përberes.

3. Rikonceptimi dhe rikonstruksioni i Qendres Kulturore te Femijeve Durres

Qendra Kulturore e Femijeve ne Durres (QKF) ka qene nje nga qendrat kuturore me te spikatura te Shqiperise ne periudhen kur ajo u themelua si qender rreth viteve '70. Ajo pervecse qender kulturore per femijet e Durresit ka sherbyer edhe si qender metodologjike per programimin kulturor per moshat e femijeve per te gjithë territorin e Shqiperise ne ato vite. Pas viteve '90, me ndryshimin e sistemeve kjo qender ruajti tiparet e saj te aktiviteve kulturore dhe artistike, port anime per vetem qytetin e Durresit. Ajo e humbi vlerat strukturore te trasheguara per shkak te humbjes se organizimeve perfekte te meparshme ne shkalle vendi. Gjithsesi, tiparet dhe karakteri i saj vazhdojne te mbahen gjalle sot me perkushtim nga tradita e edukatoreve Durresak te artit. Godina ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 2000 m2. Ajo eshte e perbere fizikisht nga dy godina te ndertuara ne periudha te ndryshme si godina Monument Kulture e kategorise se II-te e ndertuar ne kohen e pushtimit Fashist (Lufta e dyte Boterore, viti 1942.) ne orientimin Jugor dhe godina e ndertuar rreth viteve '70 ne funksion te Qendres Kulturore te Femijeve. Godina e pare dikur ka qene godine publike ne funksion te Institucionit te Agroeksportit dhe me pas ju bashkangjiti Qendres Kulturore te Femijeve me rikonstruksionin e vitit 1993. Kjo godine ka dalje te drejtperdrejte ne nje nga rruget kryesore te Durresit "Autostrada Egnatia". Ne rikonstruksionin e vitit 1993 eshte konceptuar nje hyrje e re per QKF dhe ne fakt ka funksionuar deri disa vite me pas, por ka dale jashte funksionit (duke u rikthyer tek hyrjet e dikurshme) pasi kjo godine ka pesuar demtime fizike ne tarrace dhe hidroizolimn e saj e cila ka shkaktuar me pas depertimin ne vite te lageshtise dhe dobesime te srukturese ekzistuese. Ne kushtet e sotme soleta e tarraces ka pesuar demtime te medha te ripararueshme te cilat mund te kerkojne riberjen e saj. Per shkak te rrezikshmerise se larte funksionet e QKF jane perqendruar vetem ne volumin tjetër, pra, i atij volume te trasheguar nga godina e vjeter e QKF e ndertuar ne vitet '70. Vete godina e vjeter ka pesuar disa transformime ne orientimin Perendimor. Nje volum ekzistues i saj eshte prishur per ti lene vendin ndertimit te nje godine banimi shumekateshe e cila ne kembim ka vene ne dispozicion disa ambjente te reja funksionale te cilat aktualisht funksionojne si zyra per stafin drejtues te QKF me siperfaqe rreth..... Godina ekzistuese e ndertuar ne vite permban nje salle shfaqjesh prej 200 spektatoresh, e cila funksionon edhe sot ne kushte relativisht te mira. Kjo godine permban dy hyrje te dedikuara njera per publikun ne plate ne shfaqjeve dhe tjetra per femijet per zonen e hapësira-klasave te kurse-trajnimeve. Bashkimi i dy godinave eshte realizuar me fuge per nje perimenter prej rreth 14m dhe me hapësire rreth 2m largesi per nje perimenter prej rreth 3.5m. Ky detaj arkitektonik ne kohen kur eshte realizuar shtesa e godines se QKF duhet te kete patur zgjidhjen e duhur teknike per largimin e ujerave te shiut. Ne kushtet e sotme ajo eshte kthyer ne nje "govate", qe mbledh gjithë ujerat e shiut dhe lageshtiren, duke sjelle deme te rendesishme ne strukturen e godines dhe duke nxjerre jashte funksionit disa ambjente ne kalin perdhe te godines.







Projekti duhet te arrije sa me poshte:

1. Rishikimin e ambienteve ekzistuese ne funksion te rritjes se fleksibilitetit funksional te tyre dhe veçanerisht te holleve kryesore, si hapësira ekspozimi te puneve te artit pamor te femijeve, etj.
2. Meremetimin fizik dhe nderhyrje strukturore te godinave ekzistuese, qe kane shfaqur probleme me kohen, veçanerisht godina Monument Kulture ne Jug me dalje ne rrugen "Autostrada Egnatia". Tarraca e kesaj godine (dhe soleta) duhet pare seriozisht per te siguruar shkallen e larte te rrezikshmerise se shembjes.
3. Rikthimi i shyrtes kryesore te qendres nga rruga "Autostrada Egnatia", duke rishikuar edhe lidhjet vertikale me strukturen e godines Veriore te QKF-se.
4. Permiresimin funksional dhe te rifiniturave tualeteve te QKF ne funksion te salles se shfaqjeve, por edhe zones se klasave (kurseve) si edhe mundesimin e 1 tualeti per persona me aftesi te kufizuar.
5. Permiresimi i te gjitha rifiniturave te brendshme e te jashtme te QKF, dyer, dritare, veshje apo risuvatime muresh (trajtimi akustik i disa prej tyre), ritrajtimin e shtrimeve me karakteristika fortesie fiziko-mekanike dhe njekohesisht zeabsorbuese, ritrajtimi i tavaneve i kombinuar me sistemin e ajrim kondicionimit, ndricimit, dhe absorbimit akustik.
6. Projekti duhet te parashikojë kushte teknike per te arritur koeficiente sipas normave EU per shkembimin e energjise. Per muret perimetrale (te jashtme) $U < 0.6 \text{ W/m}^2$ dhe per vetratat, profili i vetrates $U_f < 1.5 \text{ w/m}^2$ dhe xhamat $U_w < 1.4 \text{ w/m}^2$. Projektuesi duhet te marre parasysh, qe ne projektin e zbatimit te parashikojë materiale dhe sisteme, qe jane te pajisura me çertifikata Europiane per energjine dhe deklaratat e konformitetit. Arritja e ketij koeficienti mund te realizohet me aplikimin e fasadave termike, pra fasada te ventiluara, kapota termike, perdorimin e materialeve termoizoluese, etj. Ndersa per vetratat e jashtme duhet, qe projekti te specifikojë llojin e vetrates dhe detajin e profilit, qe mundeson arritjen e koeficientit te mesiperm.
7. Projekti duhet te marre parasysh arritjen e parametrave te pranueshem EU per ndotjen akustike. Koeficienti per muret e jashtme dhe vetratat duhet te jete jo me pak se 45db. Gjithashtu, projektuesi duhet te shohe permiresimin e raportit panele reflektimi dhe absorbimi tek salla e shfaqjeve, por edhe aplikimin e paneleve absorbuese ne ambientet e holleve ku krijohet zhurme nga mbivendosja e zerave te publikut apo femijeve protagonist te QKF-se.
8. Projekti duhet te realizojë te gjitha kriteret kombetare dhe EU per personat me aftesi te kufizuar.
9. Projekti duhet te respektojë normat kombetare dhe Europiane per mbrojtjen kundra zjarrit persa i perket rrugeve te shpetimit, dyerve te zjarrit qe izolojne hapësirat nga tymi, koeficientet e zjarr durueshmerise se dyerve dhe mureve per EI = 60 min zjarr,

detajet e hapjes antipanik, etj. Sistemet e perdorura duhet te jene te pajisura me certifikatat perkatese EU per mbrojtjen kundra zjarrit.

10. Impiantet mekanike ne godine duhet te perzgjidhen ne baze te kerkesave me te larta te kursimit te energjise, duke perdorur tipologji te pershtatshme per ambientet dhe destinacionin e tyre. Ne rastin e pergjithshem do te realizohet sistemi i ngrohjes per ambientet mesimore-didaktike. Ajrimi do te mundesohet te jete natyral nepermjet hapjes se dritareve aty ku eshte i mundur te realizohet. Projektuesi te shohe mundesine, qe te realizohet ne maksimumin e mundshem ajrimi horizontal dhe vertikal i holleve-korridoreve, por edhe i klasave. Por, projektuesi duhet te parashikoje gjithashtu ajrim-ngrohje ftohje kondicionim dhe furnizimi me ajer te fresket per sallen e shfaqjeve, duke siguruar temperaturat Dimer/Vere $20^{\circ}\text{C}/25^{\circ}\text{C} \pm 1^{\circ}\text{C}$, lageshtia $30\%/50\% \pm 5\%$ si dhe ajer te fresket deri ne $50\text{m}^3/\text{h}$ per person. Ky system duhet te shihet mundsisht i veqar nga pjese e tjera te godines te cilat kane nevojen e ngrohjes per periudhen e dimrit dhe ajrosjes per gjithe sezonin, por jo domosdoshmerisht ftohje kondicionim pasi ambientet shfrytezohen kryesisht ne sezonin shtator-Qershor kur temperaturat jane te pranueshme (freski ajri).
11. Impianti i mbrojtjes ndaj zjarrit, projektimi, instalimi dhe venia ne kushte pune i rrjetit hidraulik nen presion qe duhet te furnizojte me uje hydrante, naspo, apo sprinkler duhet te jene konform normes europiane UNI9490 dhe UNI 10779, nga niveli i ngarkeses se zjarrit te parashikuar (i limituar, i moderuar apo rrites) merren ne konsiderate tre zona dhe klanifikohen ne baze te normatives UNI9489 si Zona e Klasit A, Zona e Klasit B, dhe Zona e Klasit C. Per objektin dhe karkarakteristikat e tij te shfrytezimit impianti duhet projektuar me hydrante statik te normes UNI45, dhe bombola me pluhur.
12. Impianti i furnizimit me uje te ftohte sanitar duhet projektuar sipas kerkesave me te larta, duhet te garantohet nje rezerve ujore per rastet e mungeses se furnizimit nga rrjeti i qytetit dhe duhet siguruar nje sasi uji 10Lit./Person . Prodhimi i ujit te ngrohte sanitar duhet te realizohet me pompe nxehtesie per te marre ujin e ngrohte sanitar me minimumine konsumit energjitik. Akumulimi i ujit te ngrohte duhet te ruaj ujin me temperature 65°C per te mos lejuar krijimin e baktereve dhe legioneles. Duhet te kete edhe nje rezistence elektrike e cila do te jete e kontrolluar manualisht. Linja e riqarkullimit duhet te mbaje linjat me uje te ngrohte sanitar dhe programohet, qe ne nje orar te dites te beje edhe ngordhjen e mikroorganizmave dhe legioneles. Paisjet hidrosanitare duhet te jene te tipit te varur (sospeso) per te maksimalizuar higjienen ne nyjet sanitare te objektit.
13. Projekti elektrik duhet te ribehet, duke marre parasysh aplikimin e teknologjive me te perparuara per te arritur konsum minimal te energjise, veqanerisht per ndricimin, sistemin e kontrollit te hyrjes (access control-it), sistemin i video-vezhgimit, impiantin data dhe telefoni, dhe sistemin rrufeprites dhe tokezes.



14. Projekti i ndriçimit duhet te rikonceptohet ne total me sistemin BMS (Building management system) per te arritur kursimin e energjise nepermjet skenareve te funksionimit ditor apo edhe ne rastin e organizimeve te veçanta. Ndrçimi I klasave, holle dhe veçanerisht I salles se shfaqjeve duhet te shihen me vemendje te veçante nga konsulenti.
15. Projektuesi duhet te marre parasysh, qe ne projektin e zbatimit te parashikojë materiale dhe sisteme, qe jane te pajisura me çertifikata Europiane te sistemeve dhe deklarata konformiteti.
16. Projekti ne kompleksitetin e tij duhet te marre parasysh gjithshu permiresimin e shfaqjes se jashtme te objektit ne orientimin Verior per te krijuar nje identitet te mirefillte, qe do ta personifikonte ate si nje objekt me identitet te mirefillte pjesemarres protagonist ne arkitekture, ne nje funksion artistik per qytetin. Fasada nga rruga "Autostrada Egnatia" eshte e mbrojtur si monument Kulture I kategorise se dyte dhe ne keto kushte pranon vetem pastrim dhe restaurim nga demtimet fizike te kohes.

Me poshte disa nga te dhenat baze te funksioneve ne gjendjen ekzistuese dhe nevojat kryesore per shtesa funksionale ne perputhje me permiresimin e standarteve.

4. Rindertimi i shkolles "Jusuf Puka" Durres

Shkolla "Jusuf Puka" eshte shkolle 9 vjeçare e cila ndodhet ne nje pozicion teper qendror te qytetit. Aktualisht ajo ka nje numer te ulet nxenesish per shkak te hapësirave te vogla funksionale ekzistuese, qe ka. Drejtoria Arsimore Durres dhe drejtoria e cultures prane Bashkise Durres koncepton nderhyrjen ne kete shkolle si nje mundesi e mire per rritjen e kapacitetit te numrit te nxenesve te saj dhe permiresimin e kushteve te pregatitjes se brezave te ardhshem.

Projekti duhet te arrije sa me poshte:

1. Programin funksional sipas organigrames dhe siperfaqeve funksionale te kerkuara.
2. Kompozim volumetrik hapësitor qe te maksimalizojë siperfaqen e shrytezuar te hapur dhe te mundesoje ajrim dhe diellezim sa me te mire te siperfaqeve mbyllura (klasa, holle, etj).
3. Rishikimin e ambjenteve ekzistuese te mbyllura sportive te shkolles (palestra), qe te jete me parametra te standarteve Europiane (pers shkollat) per fushe basketbolli dhe volejbolli. Te parshikohen gjithashtu ambient magazinimi materialesh rreth 40 m², 2 dhoma zhveshjesh meshkuj femra, tualete dhe dushe.

4. Te shihet mundësia që në ambientet e hapura të jashtme të jenë multifunkionale për mbledhje-grumbullimin e nxenesve në orët e pushimeve, por edhe t'i dedikohen funksioneve të aktivitetit sportiv kompleks në orët e mesimit të edukimit sportiv, por edhe në orët e mbledhjes nga komuniteti i Durrësit.
5. Bibliotekë për shkollën me sipërfaqe rreth 120m²
6. Projekti duhet të parashikojë kushte teknike për të arritur koeficiente sipas normave EU për shkëmbimin e energjisë. Për muret perimetrale (të jashtme) $U < 0.6 \text{ W/m}^2$ dhe për vetratat, profili i vetrates $U_f < 1.5 \text{ W/m}^2$ dhe xhamat $U_w < 1.4 \text{ W/m}^2$. Projektuesi duhet të marrë parasysh, që në projektin e zbatimit të parashikojë materiale dhe sisteme, që janë të pajisura me çertifikata Europiane për energjinë dhe deklaratat e konformitetit. Arritja e këtij koeficienti mund të realizohet me aplikimin e fasadave termike, pra fasada të ventiluara, kapota termike, përdorimin e materialeve termoizoluese, etj. Ndërsa për vetratat e jashtme duhet, që projekti të specifikojë llojin e vetrates dhe detajin e profilit, që mundëson arritjen e koeficientit të mesiperm.
7. Projekti duhet të marrë parasysh arritjen e parametrave të pranueshëm EU për ndotjen akustike. Koeficienti për muret e jashtme dhe vetratat duhet të jete jo më pak se 45db.
8. Projekti duhet të realizojë të gjitha kriteret kombëtare dhe EU për personat me aftësi të kufizuara.
9. Projekti duhet të respektojë normat kombëtare dhe Europiane për mbrojtjen kundër zjarrit përse i përket rrugëve të shpëtimit, dyerve të zjarrit që izolojnë hapësirat nga tymi, koeficientet e zjarr durueshmërisë së dyerve dhe mureve për EI = 60 min zjarr, detajet e hapjes antipanik, etj. Sistemet e përdorura duhet të jenë të pajisura me çertifikatat përkatëse EU për mbrojtjen kundër zjarrit.
10. Impiantet mekanike në godine duhet të përzgjidhen në baze të kërkesave me të larta të kursimit të energjisë, duke përdorur tipologji të përshtatshme për ambientet dhe destinacionin e tyre. Në rastin e përgjithshëm do të realizohet sistemi i ngrohjes për ambientet mesimore-didaktike. Ajrimi do të mundësohet të jete natyral nëpërmjet hapjes së dritareve. Projektuesi të shohe mundësinë që të realizohet në maksimumin e mundshëm ajrimi horizontal dhe vertikal i holleve-korridoreve, por edhe i klasave që gjatë pushimeve kur hapjen dyert të jete i mundur ajrimi horizontal. Palestra nuk ka nevojë për ngrohje, por projektuesi duhet të mundësojë nëpërmjet rrugëve të projektimit pasiv të arrijë maksimumin për të realizuar ajrimin horizontal dhe vertikal maksimal të hapësirës së saj si edhe hijezimin. Projektuesi duhet të realizojë ajrim- ngrohje ftohje kondicionimi dhe furnizimi me ajër të freskët për sallën e shfaqjeve, duke siguruar temperaturat Dimer/Vere $20^\circ\text{C}/25^\circ\text{C} \pm 1^\circ\text{C}$, lagështia 30%/50% $\pm 5\%$ si dhe ajër të freskët deri në 50m³/h për person.
11. Impianti i mbrojtjes ndaj zjarrit, projektimi, instalimi dhe venia në kushte pune i rjetit hidraulik nën presion që duhet të furnizojë me ujë hidrante, naspo, apo sprinkler duhet të jenë konform normës europiane UNI9490 dhe UNI 10779, nga niveli i

- ngarkeses se zjarrit te parashikuar (i limituar, i moderuar apo rrites) merren ne konsiderate tre zona dhe klanifikohen ne baze te normatives UNI9489 si Zona e Klasit A, Zona e Klasit B, dhe Zona e Klasit C. Per objektin dhe karkarakteristikat e tij te shfrytezimit impianti duhet projektuar me hidrante statik te normes UNI45, dhe bombola me pluhur.
12. Impianti i furnizimit me uje te ftohte sanitar duhet projektuar sipas kerkesave me te larta duhet te garantohet nje rezerve ujore per rastet e mungeses se furnizimit nga rrjeti i qytetit dhe duhet siguruar nje sasi uji 10Lit./Person.Prodhimi i ujit te ngrohte sanitar duhet te realizohet me pompe nxehtesie per te marre ujin e ngrohte sanitar me minimumine konsumit energjistik. Akumulimi i ujit te ngrohte duhet te ruaj ujin me temperature 65°C per te mos lejuar krijimin e baktereve dhe legioneles. Duhet te kete edhe nje rezistence elektrike e cila do te jete e kontrolluar manualisht. Linja e riqarkullimit duhet te mbaje linjat me uje te ngrohte sanitar dhe programohet, qe ne nje orar te dites te beje edhe ngordhjen e mikroorganizmave dhe legioneles. Paisjet hidrosanitare duhet te jene te tipit te varur (sospeso) per te maksimalizuar higjenen ne nyjet sanitare te objektit.
 13. Projekti elektrik duhet te marre parasysh aplikimin e teknologjive me te perparuara per te arritur konsum minimal te energjise, veçanerisht per ndriçimin, sistemin e kontrollit te hyrjes (access control-it), sistemi i video-vezhgimit, impiantin data dhe telefoni, dhe sistemin rrufeprites dhe tokezues.
 14. Projektuesi duhet te marre parasysh, qe ne projektin e zbatimit te parashikojë materiale dhe sisteme, qe jane te pajisura me çertifikata Europiane te sistemeve dhe deklarata konformiteti.
 15. Projekti ne kompleksitetin e tij duhet te marre parasysh permiresimin e shfaqjes se jashtme te objektit per te krijuar nje identitet te mirefillte, qe do ta personifikonte ate si nje objekt me identitet te mirefillte pjesemarrës protagonist ne arkitekture, ne nje funksion artistik per qytetin.

Me poshte disa nga te dhenat baze te funksioneve ne gjendjen ekzistuese dhe nevojat kryesore per shtesa funksionale ne perputhje me permiresimin e standarteve.

5. Itinerar i ri turistik ne zonen historike te qytetit te Durrësit (Amfiteater – Fari)


Objektivi kryesor i ketij projekti eshte realizimi i nje intinerari, qe permbledh brenda ne nje trajektore te vetme levizjeje kembesore asetet kryesore me vlëra historike dhe kulturore te qytetit te Durrësit. Ky itinerar i dedikuar per turistet e huaj dhe vendas mund te nisi nga sheshi qendror i Durrësit prane Bashkise, te vazhdoje ne drejtim te Amfiteatrit, Muzeut Etnografik, Akropolit (forteses anzhvine dhe Karl Topise), viles Mbretërore dhe te perfundoje me Farin Detar si pike fundore dhe pike panoramike mbreselenese e qytetit. Trajektorja turistike eshte menduar te jete ciklike, duke kryer ne kthim te saj edhe

destinacionin e Muzeut Arkeologjik. Ky segment i trajektores mund te realizohet, duke shfrytezuar pjeserisht rugen kryesore ekzistuese te ngjitjes ne vilen Mbreterore dhe me pas duke prere shkurt nepermjet nje segmenti te ri te propozuar kembesor drejt Muzeut Arkeologjik. Pas ketij destinacioni turisti mund te dale drejtperdrejte ne shetitoren bregdetare te shijojë Torren e Duresit dhe nepermjet bulevardit te rikthehet ne destinacionin e pikenisjes fillestare nga sheshi qendror i qytetit. Kjo nderhyrje urbane me target zhvillimin e turizmit, gjithashtu do ta pasuroje qytetin me hapesira te reja publike te cilat do t'i bashkangjiten itinerarit fluid. Nderhyrja duhet te permbaje konceptim apo rikonceptim te hapesirave publike qe pershkuhen gjate itinerarit me elemente te shtrimeve, mobilimit urban ndricimit rrugor dhe dekorativ ndaj elementeve me vlera historike si edhe rikonstrukcionin e fasadave te objekteve me vlera arkitektonike dhe historike pergjate tij.




Amfiteatri i Duresit, fillimi i itinerarit turistik (hyrja Ju





Skema e pozicionimit të aseteve historike-kulturore në zonen historike të Durrësit



Itinerari turistik i propozuar

DETYRAT PËR T'U KRYER

Perimetri i itinerarit turistik përfshin në trajtimin e tij:

1. Perimetrin e levizjes kembesore nga shkallarja e sheshit të qendres së Durrësit (Perendimi i godines së Bashkise), që të çon drejt amfiteatrit deri tek shtepite e para që kufizojnë territorin e amfiteatrit të Durrësit në Perendim të tij.

- Dizënjimin urban dhe pejsazhistik
- Infrastrukturen rrugore për mjete motorike (nqs do të shihet e arsyeshme nga projektuesi për përmirësime të gjurmës ekzistuese) dhe gjurme të dedikuara për kembesore për grupet turistike. Të shihet mundësia edhe për path biçikletash.
- Trajtimin e fasadave të banesave njëfamiljare që ballafaqohen me hapësirat publike, meremetim, lysterje. Vëmendje të veçantë projektuesi duhet t'i kushtojë viles së Toptanasve që përben 1 aset arkitekturor dhe historik, që mund të jetë njëkohësisht edhe pjesë e itinerarit turistik.

•

2. Perimetrin e rrugicës ekzistuese 1, që lidh rrugën "Sotir Noka" me Fortesën Anzhuinë.

- Dizënjimin urban
- Infrastrukturen rrugore për mjete motorike (nqs do të shihet e arsyeshme nga projektuesi për përmirësime të gjurmës ekzistuese) dhe gjurme të dedikuara për kembesore për grupet turistike. Të shihet mundësia edhe për path biçikletash.
- Trajtimin e fasadave dhe gardhimeve të banesave njëfamiljare që ballafaqohen me hapësirat publike, meremetim, lysterje, etj.

3. Perimetrin e sygjerruar për lidhje 2, që mundet të lidhi rrugën "Sotir Noka" me Fortesën Anzhuinë.

- Hapje të një gjurme të re për lidhjen e rrugës "Sotir Noka" me Fortesën Anzhuinë. Propozim për gjurme shpronësi në oborret e shtëpive ekzistuese, duke demtuar sa më pak nga godinat ekzistuese.
- Dizënjimin urban të gjurmës së re me shtrime të kujdesshme të dedikuara për kembesore për grupet turistike. Të shihet mundësia edhe për path biçikletash.
- Trajtimin e fasadave dhe gardhimeve të banesave njëfamiljare që ballafaqohen me këto gjurme të re, meremetim, lysterje, etj.

4. Perimetrin e rrugicës ekzistuese 3, që lidh rrugën "Sotir Noka" me Fortesën Anzhuinë.

- Dizënjimin urban të gjurmës ekzistuese



- Infrastrukturen rrugore per mjete motorike (nqs do te shihet e arsyeshme nga projektuesi per permiresime te gjurmes ekzistuese) dhe gjurme e dedikuar per kembesore per grupet turistike. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash.
- Trajtimin e fasadave dhe gardhimeve te banesave njefamiljare që ballafaqohen me kete gjurme te re, meremetim, lysterje, etj, ne rastin ku kemi te tilla.

5. Perimetrin e rruges automobilistike dhe kembesore nga fortesa Anzhuine e Kan Topise deri tek Vila Mbreterore ne Perendim.

- Dizenjimin urban te gjurmes se re me shtrime te kujdesshme te dedikuar per kembesore per grupet turistike. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash.
- Infrastrukturen rrugore per mjete motorike (nqs do te shihet e arsyeshme nga projektuesi per permiresime te gjurmes ekzistuese) dhe gjurme e dedikuar per kembesore per grupet turistike. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash.
- Trajtimin e fasadave dhe gardhimeve te banesave njefamiljare që ballafaqohen me kete gjurme te re, meremetim, lysterje, etj, ne rastin ku kemi te tilla.

6. Perimetrin nga Vila Mbreterore deri tek Fari Detar ne Perendim.

- Dizenjimin urban te gjurmes se re te pershtatur me rrugen ekzistuese me shtrime te kujdesshme te dedikuar per kembesore per grupet turistike. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash.
- Ne perfundim te gjurmes se rrugen ekzistuese automobilistike, hapja e nje gjurme e re qe te percjell drejt Farit Detar. Konceptimi i nje sheshi publik rreth Farit Detar si fundi i itinerarit turistik. Ruajtja e te gjitha kriterëve te sigurise per Farin si element i sigurise se larte rakorduar me Drejtorine e Portit te Duresit.
- Te shihet mundesia e aksesit edhe per path biçikletash.

7. Perimetrin nga Vila Mbreterore tek Muzeu Arkeologjik.

- Dizenjimin urban dhe pejsazhistik
- Pershtatja e gjurmes se rruges ekzistuese me nje gjurme shtese te dedikuar per kembesore per grupet turistike. Te shihet mundesia edhe per path biçikletash. Zgjerim i trotuarit ekzistues, etj.
- Hapja e nje gjurme te re lidhese te rruges ekzistuese automobilistike dhe trotuarit te saj me Muzeun arkeologjik nepermjet nje shkallareje apo sistemi rampash kembesore.

Gjurma e propozuar e rruges

1. Duke perdorur si baze gjurmen e rruges ekzistuese (ne rastin e rehabilitimeve dhe rindertimeve), profilin dhe llojin e terrenit te nxjerre ngaurvejimet topografike,

konsulenti duhet te pergatise nje projekt final duke perfshire intersektimet, afersine me rruge te tjera dhe zonat urbane. Ne realizimin e ketij projekti, pritet qe Kontraktori te perdore programe kompjuterike lehtesuese ne projektimin e rruges. Duhet bere gjithashtu ri-projektimi i gjurmes ne menyre, qe te lehtesoje kthesat e forta, per sigurimin e shikueshmerise, etj. Elementet e profilit terthor duhet te projektohen ne perputhje me udhezimet e projektimit te rrugeve. Te shihet mundesia e vecimit qartazi te gjurmes se levizjes kembesore nga gjurma e levizjes automobilistike. Brenda mundesive ne trakte te caktuara rrugore te evidentohet vizualisht dhe funksionalisht edhe gjurma e levizjes me biciklete.

2. Vizatimet per planimetrite e kryqezimeve, prerjet ne zonat urbane dhe karakteristika te tjera te rendesishme do te pergatiten ne nje shkalle te pershtatshme me te madhe me instalimet e nevojshme dhe informacionin e drenazhit. Per zonat urbane duhet te jepen detajet e sherbimeve, drenazhimi, zonat e parkimit, trotualet, ndricimi, etj. Duhet te realizohen vizatimet standarte per shenjat e trafikut, vijeziemet dhe karakteristika te tjera te kontrollit dhe sigurise se trafikut, puseta per fibra optike, struktura drenazhi te vogla dhe elemente te tjere te vegjel.
3. Shtresat - Projektimi i paketes se shtresave duhet te pergatitet bazuar ne: • Standartet e projektimit dhe ngarkesat e trafikut, percaktuar nga konsulenti; • Ne gjetjet e investigimit gjeoteknik dhe gjendjes se rruges te vleresuara nga konsulenti, te ndermarra sipas paragrafit 2.4, integruar me te dhenat e disponueshme nga databaza e shtetit (aty ku eshte e mundur); dhe • Deflektori i rruges
4. Sistemi i Drenazhimit dhe Punimet Mbrojtese
5. Sistemi gjatesor i drenazhimit i integruar me sistemin terthor te tij do te zbatohet ne te gjitha gjatesine e projektit. Projektimi i drenazhit duhet te perfshije integrimin e drenazhit te rruges me sisteme te tjera drenaxhi (nese ka) si dhe projektimin e drenazhit per kryqezime.
6. Te tregohet kujdes ne zgjidhjet teknike te drenazheve gjatesore neper kryqezimet e rruges. Per seksione te rruges me karakteristika specifike duhet te parashikohen sisteme drenazhimi te posaqme.

Punime bio-inxhinjerike

3. Do te vleresohen teresisht nga konsulenti kerkesat per punime mbrojtese per te siguruar qendrueshmerine e skarpatave dhe rezistencen e dheut ndaj erozioni! pergjate ndonje terreni me potencial rreshqites dhe shiresave te dheut te pakonsoliduara, pergjate rruges dhe duhet te behen parashikime te sakta per veprat bio - inxhinjerike.
4. Punimet bio-inxhinjerike duhet te zgjidhen sipas tipit te bimesise, vendodhjes dhe detajeve te tjera, ne specifikime dhe vizatime. Punimet mbrojtese do te perfshijne gjithashtu mbrojtjen e rrjedhes se sipërme/poshtme ujore qe potencialisht mund te pershkoje rrugen.



Strukturat

4. Duhet të përgatiten projekte të detajuara të strukturave. Projektet do të hartohen për të maksimizuar përdorimin e komponenteve standarde dhe projekteve të strukturave. Në veçanti për struktura të vogla; tombino rrethore apo box, struktura të mbikalimeve apo nenkalimeve, etj. me alternativa të preferuara të parafabrikuara.
5. Nenstrukturat do të dimensionohen mbi bazën e investigimeve të detajuara në terren, duke reflektuar praktiken më të mirë ndërkombëtare. Në zgjedhjen e tipit të themeleve Kontraktori duhet të marrë parasysh gjithashtu kohën e kërkuar për ndërtimin e alternativave, dhe t'i japë përpjesë atyre, që shkurtojnë kohën e ndërtimit. Projektimi i urave duhet të marrë parasysh kërkesën për trotuar për kembësoret.
6. Llogaritjet duhet të kryhen në përputhje me praktikën e pranueshme ndërkombëtare (si p.sh. Eurocodet siç jepet në Sek 4 të draftit ARDM5.1) dhe do të përdoren teknikat kompjuterike. Sizmika dhe të dhëna të tjera do të merren parasysh sipas nevojës.

Mjetet e Sigurisë Rrugore, Kontrollit të Trafikut dhe Facilitete të Tjera

4. Rekomandimet për siguri në rrugë do të integrohen në projektin inxhinierik në formën e planimetrive të përmirësuar të kryqezimeve, arranzhimin e kufizueseve të trafikut për uljen e shpejtësisë së automjeteve, facilitetet për kembësoret, vijezimi i rrugës i përmirësuar dhe instalimi i shenjave të trafikut, delineatorët e rrugës, spotet fluorishente dhe çdo zbutës tjetër trafiku dhe/ose mjete të sigurisë rrugore të menduara të nevojshme nga Kontraktori.
5. Planimetritë e vijezimit të rrugës dhe shenjave të trafikut do të përgatiten për levizjen e sigurt dhe efikasë të trafikut. Të dyja duhet të bazohen në praktikën ndërkombëtare për rrugë të tipit të tillë, rregulluar sipas diskutimeve me Autoritetin Kontraktor të përbashkët Kodin e Rrugeve Shqiptare aktual: "RREGULLORE PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR" (zbatimi i kodit rrugor) Vol. II "STANDARTET E SINJALIZIMIT RRUGOR" dhe draft Manualit të Projektimit të Rrugeve për Shqipërinë ARDM6.
6. Duhet të përgatiten projektet e ndriçimit të rrugës për seksionet brenda zonës urbane dhe zona të tjera ku është i nevojshëm ndriçimi.

2. Projekt – Zbatimi

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktues, Kontraktori do të hartojë projektin e zbatimit, i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për zbatim.

Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

1. Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit.

si dhe të asaj të zbatimit të punimeve. Studimi duhet të përmbajë informacion për ujrë siperfaqësore dhe nentokesore dhe strukturat e drenazheve.

2. Për të kryer survejimin topografik, Kontraktori do të perdorë Total Station, GPS ose pajisje të ngjashme me të në teknike dhe procedura, të cilat zhvillohen në kompjuter, në bazë të modelimit topografik të terrenit.

Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik dhe Investigimit të Materialeve

1. Kontraktori në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dalë gjatë shqyrtimit të projekt-idesë pranë Autoritetit Kontraktues.
2. Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:
 - a. tekstin e raportit, parametrat gjeoteknikë të projektimit;
 - b. materialin grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të veçantë të shpimeve;
 - c. cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues (nese ka);
 - d. konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

Investigimet Hidrologjike dhe Hidraulike

1. Kontraktori duhet të bëjë një studim me të dhëna shtesë të vlefshme dhe të nevojshme mbi hartën topografike, kohezgjatjes së rreshjeve, statistikave të tyre, karakteristikave të dheut bimesise etj, në mënyrë që të ketë akses në zonën ujembledhese si dhe parametrat hidraulike për të gjitha strukturat dhe tombinot ekzistuese dhe të reja që do të parashikohen në projekt.
2. Kontraktori do të mbledhë informacion mbi nivelet e permbytjes, kuotën e ulet të ujrave, shpejtësinë e shkarkimit etj, nga të dhëna të mëparshme të disponueshme, nga raporte të investigimit ekzistues dhe shënja të dukshme në terren.

Investigimi i Shërbimeve Publike

1. Kontraktori duhet të mbledhë detaje të çdo parametri fizik përgjatë rrugës së rrugës, linjat e shtyllat elektrike e të telefonise, shërbimet nentokesore, vendodhjet e pusëtave, si dhe tipe të tjera shërbimesh si p.sh: fibra optike, pusëtat e shiut, ujërave të zeza, tubacione të gazit/naftës në mënyrën e duhur dhe që pritet të preken nga ndërtimi i rrugës. Informacioni i mbledhur duhet të paraqitet në një plan zhvendosjesh në mënyrë që zgjatja e afatit të dorëzimit dhe rivendosja e strukturave dhe shërbimeve të mund të vlerësohen në mënyrë të përshtatshme. Plane zhvendosjeje të ndara për çdo shërbim (energji, telefon, ujë etj.) të përfshirë, duhet të përgatiten për të lehtësuar kështu koordinimin me agjensitë në ngarkim.
2. Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit



3. Mbas përpunimit të projektit dhe hartimit të projektit përfundimtar të zbatimit, konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet t'i referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje konsulenti.
4. Konsulenti do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes së materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre.
5. Në këtë fazë gjithashtu, kontraktori do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të spostimeve të ndryshme elektrofonike apo të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.
6. Kontraktori do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra gjatë zbatimit të punimeve për sigurinë në punë.

Volümet e punës dhe Preventivi

1. Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve, që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).
2. Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë çmimet njësi të Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit, në fuqi. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar, duhet të shoqërohen me analizën e llogaritjes së çmimit.
3. Preventivi do të shoqërohet edhe me dhe grafikun e punimeve.
4. Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit
5. Raporti i projektit përfundimtar të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mëposhtëm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

Raporti duhet të përmbajë:

Raportin teknik të projektimit arkitektonik.

Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitrarëve, trarëve, etj.), si dhe masat inxhinierike, që janë parashikuar të merren, si siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit etj. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.

Preventivi i plotë.

Vizatimet përfundimtare

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të përgatise e dorëzoje vizatimet e mëposhtme si pjesë bazë e dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve. Vizatimet perfundimtare të projekt zbatimit duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:
Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)

2.13 Vizatimet

2.13.1 Kontraktori në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të përgatise e dorëzoje vizatimet e mëposhtme, si pjesë bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Plani i Përgjithshëm i pozicionimit të zonës së ndërhyrjes në lidhje me qytetin 1:25000 (1:10000)..
- Plani i përgjithshëm i ndërhyrjes Sh 1:1000/2000
- Planimetri të zmadhuara në shkallë pjesë të planit teresor të identifikuar për pozicionimin në skemën e përgjithshme sh 1:100/200
- Planimetri e rrjeteve kryesor dhe shpërndaresh të ujit të pijshëm në shkallë 1:1000
- Planimetri e rrjeteve kryesor të kanalizimeve të ujërave të zeza në shkallë 1:1000
- Planimetri e rrjeteve kryesor dhe shpërndaresh të ujit të pijshëm në shkallë 1:1000
- Planvendosje dhe prerje të kaptazheve të ujit në shkallë 1:500
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1:100
- Profila tërthor SH 1:20
- Detaje të ndryshme (puseta ajrimi, shkarkimi, kontrolli, etj) SH 1:25; 1:50
- Harta e rievimit topografik SH 1:1000
- Harta hidrologjike SH 1:5 000
- Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200
- Grafiku i punimeve

Nqs ndërhyrja urbane përfshin në konceptimin e saj edhe ndërhyrje në fasadat ekzistuese duhet të paraqiten gjithashtu:

- Foto të fasadave ekzistuese
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e propozuara Shk.1:100

Grafiku i punimeve

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis

Projekt zbatimi do të përmbajë edhe Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), hartuar në përputhje me kërkesat e renditura në Aneksin 6.



6. Porta e Jallise – Hamami

Porta e Jallise u ndertua ne shekullin VI dhe sherbente si hyrja kryesore e qytetit te Kalase se Durrësit, Ajo u prish ne vitin 1930 per t'i hapur vend ndertimit te rruges tregtare (sot bulevardi "Epidamn") nga plani rregullues urbanistik Italian i paraLuftes se Dyte Boterore. Projekti do te mund te riktheje memorien historike te kesaj porte teper te rendesishme per qytetin e Durrësit te per gati 14 shekuj. Trakti i hyrjes ne porte dhe vazhdimesia e saj gjithashtu jane "fshire" nga i njeiti plan urbanistik, duke vendosur ne krah tij godina formuluese perimetrale te bulevardit kryesor "Epidamn" ne Perendim dhe godina te tjera te pas Luftes ne Lindje. Por perimetri i ish rruges hyrese ne qytet ka ngelur i paprekur si hapësire fizike dhe ai e ka te gjithë potencialin te rijetesohet i lidhur me gjurmen e portes se Jallise.






Pjese e ketij trakti rrugor hyres ne qytet ka qene edhe godina e Hamamit, qe sot ruhet si godine me vlera historike dhe arkitekture i periudhes otomane. Ky objekt gjendet sot i eklipsuar nga nderhyrja urbane e viteve '30 si edhe nga nderhyrjet ne kohe me mure kufizuese, etj, qe e fshehin ate. Projekti do mund te propozonte evidentimin e ketij objekti si pjese e nje "path-i" historik, qe fillon me gjurmen e portes se Jallise dhe perfundon me godinen e Hamamit dhe me pas del tek sheshi trekendor i bulevardit Epidamn.

Pervec evidentimit te dy elementeve historik, nderhyrja do behej shkas edhe per perfitimin e nje hapësire urbane fizikisht ekzistente, por jo "de facto" funksionale. Nderhyrja duhet te permbaje konceptim apo rikonceptim te hapësirave publike qe pershkuhen gjate itinerarit me elemente te shtrimeve, mobilimit urban ndricimit rrugor dhe dekorativ ndaj elementeve me vlera historike si edhe rikonstrukcionin e fasadave te objekteve me vlera arkitektonike dhe historike pergjate tij.





DETYRAT PËR T'U KRYER

Perimetri i itinerarit turistik përfshin në trajtimin e tij:

1. **Gjetjen artistiket e nje menyre simbolike per percjelljen e prezences se dikurshme te Portes se Jallise si porta hyrese ne qytetin e Duresit**
 - Përveç zgjidhjes arkitektonike, skulpturale, që do të identifikojë prezencën e dikurshme të Portes së Jallisë konsulentit duhet të parashikojë edhe një tabelë ku do të jetë e shkruar historia e kësaj porte e lidhur me historinë e vetë qytetit të Durrësit.
2. **Perimetrin e levizjes kembesore nga vendodhja e hershme e Portes se Jallise deri tek sheshi trekendor i bulevardit "Epidamn"**
 - Dizajnimin urban të hapësirës së formuar nga prishja e rrethimeve informale.
 - Gjurme të dedikuara për kembësorë për grupet turistike. Të shihet mundësia edhe për path dhe parkim biçikletash.
 - Trajtimin e fasadave të banesave njëfamiljare që ballafaqohen me hapësirat publike, meremetim, lysterje.

3. Rikonceptimi i hapësirës rrethuese të Hamamit dhe ndriçimit dekorativ të saj.

- Dizënjimin urban të hapësirës rrethuese të Hamamit.
- Restaurimin e jashtëm të godinës së Hamamit (fasada, etj) në përshatje me kriteret e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Projekti - Zbatimi

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktues, Kontraktori do të hartojë projektin e zbatimit, i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për zbatim.

Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

3. Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj të zbatimit të punimeve. Studimi duhet të përmbajë informacion për ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe strukturat e drenazheve.
4. Për të kryer survejimin topografik, Kontraktori do të perdore Total Station, GPS ose pajisje të ngjashme me të në teknike dhe procedura, të cilat zhvillohen në kompjuter, në baze të modelimit topografik të terrenit.

Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik dhe Investigimit të Materialeve

3. Kontraktori në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt-idesë pranë Autoritetit Kontraktues.
4. Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:
 - e. tekstin e raportit, parametrat gjeoteknike të projektimit;
 - f. materialin grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të veçantë të shpimeve;
 - g. cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues (nese ka);
 - h. konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

Investigimet Hidrologjike dhe Hidraulike

3. Kontraktori duhet të bëjë një studim me të dhëna shtesë të vlefshme dhe të nevojshme mbi hartën topografike, kohezgjatjes së rreshjeve, statistikave të tyre, karakteristikave të dheut bimesise etj, në mënyrë që të ketë akses në zonën ujembledhese si dhe parametrat hidraulike për të gjitha strukturat dhe tombinat ekzistuese dhe të reja që do të parashikohen në projekt.



4. Kontraktori do të mbledhe informacion mbi nivelet e permbytjes, kuoten e ulet të ujërave, shpejtesinë e shkarkimit etj, nga të dhëna të mëparshme të disponueshme, nga raporte të investigimit ekzistues dhe shënja të dukshme në terren.

Investigimi i Shërbimeve Publike

1. Kontraktori duhet të mbledhe detaje të çdo parametri fizik përgjatë gjurmës së rrugës, linjat e shtyllat elektrike e të telefonisë, shërbimet nentokesore, vendodhjet e pusëtave, si dhe tipe të tjera shërbimesh si p.sh: fibra optike, pusëtat e shiut, ujërave të zeza, tubacione të gazit/naftës në menyren e duhur dhe që pritet të preken nga ndërtimi i rrugës. Informacioni i mbledhur duhet të paraqitet në një plan zhvendosjesh në mënyrë që zgjatja e afatit të dorëzimit dhe rivendosja e strukturave dhe shërbimeve të mund të vlerësohen në mënyrë të pershtatshme. Plane zhvendosjeje të ndara për çdo shërbim (energji, telefon, ujë etj.) të përfshirë, duhet të përgatiten për të lehtësuar kështu koordinimin me agjensite në ngarkim.
7. Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit
8. Mbas përpunimit të projektit dhe hartimit të projektit përfundimtar të zbatimit, konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet t'i referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet t'i kushtojë vëmendje konsulenti.
9. Konsulenti do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes së materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre.
10. Në këtë fazë gjithashtu, kontraktori do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të postimeve të ndryshme elektrofonike apo të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.
11. Kontraktori do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra gjatë zbatimit të punimeve për sigurinë në punë.

Volumet e punës dhe Preventivi

4. Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve, që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).
5. Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre. Çmimet do të jenë çmimet njësi të Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit, në fuqi. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar, duhet të shoqërohen me analizën e llogaritjes së çmimit.
6. Preventivi do të shoqërohet edhe me dhe grafikun e punimeve.
7. Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit

8. Raporti i projektit perfundimtar të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mëposhtem si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

Raporti duhet të përmbajë:

Raportin teknik të projektimit arkitektonik.

Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për gjithë strukturat (themelet, shkallëve, soletave, arkitarëve, trarëve, etj.), si dhe masat inxhinierike, që janë parashikuar të merren, si siguria e kalimit në objekt gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit etj. Në këtë raport do të bashkëngjiten dhe anekset përkatëse ku janë të gjitha llogaritjet përfshirë modelin kompjuterik të llogaritjeve për kontrollet eventuale nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.

Preventivi i plotë.

Vizatimet perfundimtare

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të përgatise e dorezoje vizatimet e mëposhtme si pjesë bazë e dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve. Vizatimet perfundimtare të projekt zbatimit duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)

2.13 Vizatimet

2.13.1 Kontraktori në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të përgatise e dorezoje vizatimet e mëposhtme, si pjesë bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve:

- Plani i Përgjithshëm i pozicionimit të zones së ndërhyrjes në lidhje me qytetin 1:25000 (1:10000)..
- Plani i përgjithshëm i ndërhyrjes Sh 1:1000/2000
- Planimetri të zmadhuara në shkallë pjesë të planit teresor të identifikuar për pozicionimin në skemën e përgjithshme sh 1:100/200
- Planimetri e rrjeteve kryesor dhe shperndares se ujit te pijshem në shkallë 1:1000
- Planimetri e rrjeteve kryesor te kanalizimeve te ujerave te zeza në shkallë 1:1000
- Planimetri e rrjeteve kryesor dhe shperndares se ujit te pijshem në shkallë 1:1000
- Planvendosje dhe prerje të kaptazheve të ujit në shkallë 1:500
- Profil gjatësor H 1:1000 V 1:100



- Profila tërthor SH 1:20
- Detaje të ndryshme (puseta ajrimi, shkarkimi, kontrolli, etj) SH 1:25; 1:50
- Harta e rievimit topografik SH 1:1000
- Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200
- Grafiku i punimeve

Nqs nderhyrja urbane perfshin ne konceptimin e saj edhe nderhyrje ne fasadat ekzistuese duhet te paraqiten gjithashtu:

- Foto te fasadave ekzistuese
- Fasadat ekzistuese Shk.1:100
- Fasadat e propozuara Shk.1:100

Grafiku i punimeve

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis

Projekt zbatimi do te permbaje edhe Raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM), hartuar ne perputhje me kerkesat e renditura ne Aneksin 6.